



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Ekonomiks” i
Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Ismail Qemali”,
Vlorë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Raimonda Duka

2. Dr. Andromahi Kufo

Maj 2020

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit Bachelor në "Ekonomiks" është hapur me vendim të MASH Nr.124, datë 17.02.2010 dhe ka për qëllim përgatitjen e specialistëve në fushën e ekonomisë. PS është ofruar për herë të parë në vitin akademik 2010-2011. Programi i studimit realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale është tre vite akademike. Programi i studimit Bachelor në "Ekonomiks" është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL".

Qëllimi i programit të studimit është pajisja e studentëve me njohuri bazë në fushën e ekonomisë, aftësimi i tyre në përdorimin e metodave dhe parimeve shkencore të përgjithshme, në mënyrë që ata të mund të kuptojnë dhe aplikojnë parimet ekonomike në jetën e tyre të përditshme. Departamenti i Ekonomiksit ka përcaktuar disa objektiva specifike për arritjen e këtij qëllimi si: (i) përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe i cilësisë së stafit akademikë; (ii) përmirësimi i partneritetit të programit të studimit me aktorë të jashtëm për t'u përfshirë në zhvillimin ekonomik rajonal; (iii) rritja e cilësisë së studentëve në hyrje dhe rritja e numrit të studentëve që ndjekin këtë program studimi.

Programi i studimit ofrohet nga Departamenti Ekonomiksit, i cili e ka filluar veprimtarinë e tij në vitin akademik 2010-2011. Departamenti i Ekonomiksit ofron programe studimi në ciklin e parë dhe ciklin e dytë. Aktualisht departamenti ka në përbërjen e tij 7 personel me kohë të plotë dhe 2 personel me kohë të pjesëshme. Mësimdhënia në programin e studimit mbulohet kryesisht nga stafi me kohë të plotë i Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali". Personeli me kohë të plotë krahas angazhimit në mësimdhënie, është i përfshirë dhe në punë kërkimore-shkencore në funksion të mësimdhënies dhe zhvillimit ekonomik lokal/kombëtar.

Departamenti i Ekonomiksit bashkëpunon me institucione të tjera të arsimit të lartë (kombëtare dhe ndërkombëtare) në fushën e mësimdhënies, organizimit të konferencave shkencore dhe pjesëmarrjen si partnerë në projekte të ndryshme. Departamenti bashkëpunon gjithashtu me institucione të tjera private dhe publike për arritjen e objektivave të tij në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Universiteti "Ismail Qemali" ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Bachelor në Ekonomiks në datën 12.07.2019 nëpërmjet shërbimit AMS.ASCAL dhe Bordi i Akreditimit për zgjodhi dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga FE, Universiteti "Ismail Qemali", bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017". Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga Dr. Andromahi Kufo dhe Prof.Dr. Raimonda Duka. Detyra e ekspertëve të jashtëm ishte përpilimi i raportit të vlerësimit të jashtëm, mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit të përcjellë nga institucioni dhe gjetjeve gjatë kryerjes së vizitës në institucion. Grupi i punës u mbështet gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm nga koordinatori teknik i ASCAL, Z. Erion Xhako.

Dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësimin e jashtëm iu vendos në dispozicion grupit të punës në datën.27.01.2020. Ekspertët patën në dispozicion rreth 3 javë për të studiuar dokumentat, për të evidentuar nevojën për informacion shtesë dhe për të hartuar pyetjet për vizitën në institucion. Agjenda e vizitës në institucion u miratua në 11.02.2020 dhe vizita u realizua në datat 25 dhe 26 Shkurt 2020 në mjediset e Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali". Institucioni mbështeti vizitën e grupit të vlerësimit të jashtëm me të gjithë infrastrukturën e nevojshme gjatë vizitës në institucion. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u paraqit gjatë vizitës dhe u vu në dispozicion përmes sistemit AMS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve për subjekte të caktuara, GVJ paraqet vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Bachelor në Ekonomiks si më poshtë. Në fund të raportit është paraqitur analiza përfundimtare për programin e studimit që akreditohet dhe janë dhënë disa rekomandime për institucionin. Raporti është hartuar në bashkëpunim të ngushtë midis dy eksperëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Më datë 08.05.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 34/46 Prot., datë 11.05.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 14.05.2020 dhe me shkresë Nr. 732/2 Prot., datë 14.05.2020

Shënim: Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm, ka ardhur si pasojë pandemisë së COVID-19. Komunikimi me IAL është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132, datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91, dt. 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190, datë 19.03.2020.



GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin I.5 Kriteri 3** "Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi që analiza është e fokusuar më shumë në nivel produktesh dhe jo në rezultatet e bashkëpunimeve dhe rekomandon që në të ardhmen të reflektohen në raportet periodike përfitimet në funksion të PS-it nga zbatimi i marrëveshjeve dhe bashkëpunimet".

Komenti i IAL: Raporti vjetor i Departamentit të Ekonomiksit për vitin akademik 2018-2019, është hartuar në mbështetje të nenit 32 të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", udhëzimit të MASR, nr.5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementëve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë". Në këtë raport është dhënë:

- informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor ku, cilësohen objektivat dhe strategjitë e përdorura për arritjen e objektivit të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. (*Evidenca II.14 Miratimi dhe përcjellja e raportit vjetor të Departamentit të Ekonomiksit, faqe 3-4*)
- informacion mbi kërkimin shkencor lidhur me politikat e kërkimit shkencor, të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, kërkimi shkencor i realizuar nga personeli akademik i Departamentit të Ekonomiksit. (*Evidenca II.14 Miratimi dhe përcjellja e raportit vjetor të Departamentit të Ekonomiksit, faqe 4-7*)
- të dhëna mbi programet e studimit referuar dhe riorganizimeve të tyre bazuar në ndryshimet ligjore dhe nënligjore. (*Evidenca II.14 Miratimi dhe përcjellja e raportit vjetor të Departamentit të Ekonomiksit, faqe 7*)
- informacion mbi personelin akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme të angazhuar në mësimdhënie për vitin akademik 2018-2019, bazën ligjore të referuar mbi shpërndarjen e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2018-2019. (*Evidenca II.14 Miratimi dhe përcjellja e raportit vjetor të Departamentit të Ekonomiksit, faqe 7-8*)
- informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar, transferuar, degë të dytë, të diplomuar, të çregjistruar, ekselentë, etj. (*Evidenca II.14 Miratimi dhe përcjellja e raportit vjetor të Departamentit të Ekonomiksit, faqe 8-10*)



- informacion mbi cilësinë e kalueshmërinë për të gjitha programet e studimit që ofron Departamenti i Ekonomiksit. (*Evidenca II.14 Miratimi dhe përcjellja e raportit vjetor të Departamentit të Ekonomiksit, faqe 10-13*)

Argumenti i GVJ: Ekspertët nuk kanë gjetur mospërputhje të raportit vjetor me kërkesat e ligjit dhe udhëzimin e MASR. Megjithatë nënvizojmë që **Kriteri 3** kërkon që njësia bazë të hartoj raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit (sipas Kodit të Cilësisë, miratuar me VKM nr.531, datë 11.09.2018). GVJ nuk e ka konsideruar si mangësi, por ka dhënë rekomandimin që kjo kërkesë e Kodit të Cilësisë të reflektohet në të ardhmen përmes raportit vjetor të njësisë bazë. Vlerësimi i këtij kriteri nuk e ka influencuar vlerësimin për shkallën e përmbushjes së standardeve të fushës I. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

2. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin II.1 Kriteri 4:** "Në mënyrë që plani mësimor të jetë më shumë i orientuar drejt aftësive dhe kompetencave GVJ sugjeron disa ndryshime të vogla në lëndët karakterizuese si: Tregëti Ndërkombëtare dhe Financa Ndërkombëtare të zhvillohen si një lëndë e vetme me emërtimin "Ekonomiksi Ndërkombëtar", Ekonomiksi Menaxherial të zëvendësohet me Ekonomiksin Industrial ose me praktikën profesionale, Ekonomiksi Financiar, Rritja Ekonomike dhe Teoritë e Rritjes me lëndë si Histori Ekonomie, Ekonomiks Mjedisi, Ekonomiks Urban ose module të përafërta. GVJ sugjeron gjithashtu futjen e praktikës profesionale në planin mësimor".

Komenti i IAL: Së pari, ju sqarojmë se në Planin Mësimor të Bachelor në "Ekonomiks", nuk kemi lëndë me emërtimin "Financa Ndërkombëtare". Sqarojmë se lënda "Tregtia Ndërkombëtare" bën pjesë në planin mësimor të Bachelor në "Ekonomiks", ndërkohë plotësohet me lëndën "Ekonomiks Ndërkombëtar" në planin mësimor të Masterit Profesional "Ekonomiks Sipërmarrje".

Gjithashtu pjesë e planit mësimor të bachelor në "Ekonomiks" është lënda "Histori e Mendimit Ekonomik", trajton të njëjtën gjë si lënda "Histori Ekonomie" që ka sugjeruar GVJ, për këtë arsye jemi të mendimit se plotësohet kjo domosdoshmëri formimi në pikëpamjen historike të ekonomisë.

Përsa i përket lëndëve që GVJ ka sugjeruar si "Ekonomiksi Industrial" dhe "Ekonomiks Mjedisi", të cilat përmbajnë njohuri më profesionale dhe më të avancuara se "Ekonomiks Manaxherial", Departamenti i Ekonomiksit i ka përfshirë ato në nivelin master, si në

Masterin Profesional "Ekonomiks në Sipërmarrje" ashtu edhe Master Shkencor në Ekonomiks.

Theksojmë se lënda "Ekonomiks Manaxherial" është një lëndë pararendëse e lëndëve më lart. Ju bëjmë me dije se plani mësimor bachelor në "Ekonomiks" përmban vetëm një lëndë "Mikroekonomi" dhe përfshirja e lëndës "Ekonomiks Manaxherial" mundëson kalimin dhe zhvillimin e njohurive të mëtejshme për lëndët e sugjeruara nga GVJ.

Lënda "Ekonomiks Manaxherial" është menduar nga departamenti të jetë pjesë e planit mësimor për arsye se plani mësimor bachelor në "Ekonomiks" përmban vetëm një lëndë "Mikroekonomi", ndërkohë "Ekonomiksi industrial" është lëndë e përfshirë në Masterin Profesional "Ekonomiks në Sipërmarrje" ashtu edhe Master Shkencor në Ekonomiks.

GVJ sugjeron përfshirjen e lëndës "Ekonomiks Urban" në nivelin bachelor, por në programin tonë ajo është përfshirë në planin mësimor të Masterit Profesional "Ekonomiks në Sipërmarrje". Ndërkohë GVJ sugjeron heqjen e lëndëve "Ekonomiks Financiar", "Rritja Ekonomike dhe Teoritë e Rritjes".

Duhet të theksojmë se programi bachelor është një program i cili i përgatit studentët me njohuri bazë të Ekonomiksit, dhe domosdoshmëria e hapjes së kësaj dege jo vetëm në vendin tonë, ka ardhur si nevojë e studimit të rritjes ekonomike dhe teorive të saj, si një qëllim primar i çdo forme shoqërore. Prandaj përfshirja e saj është një domosdoshmëri për përgatitjen e ekonomistëve të ardhshëm në vendin tonë.

Gjithashtu, arsyetojmë se përfshirja e lëndës Ekonomiksi Financiar është një komplementare e lëndëve më lart, sepse ajo trajton aktivitetin financiar të një ekonomie. Theksojmë se qarkullimi i mallrave ekonomike shoqërohet domosdoshmërisht me qarkullimin monetar. Sot jetojmë në një botë kapitaliste dhe studentët duhet të kuptojnë rëndësinë e parasë, si dhe efektet që kanë politikatat ekonomike mbi sektorin financiar, të cilat janë të pandashme nga njëra-tjetra. Prandaj menduam se përfshirja e kësaj lënde në planin mësimor përbën një nevojë.

Duam të sqarojmë gjithashtu se, arsyeja e mospërfshirjes së praktikës në ciklin bachelor në Ekonomiks ka qënë:

- Në syllabuset e lëndëve janë planifikuar projektet, detyrat e kursit, rastet e studimit kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Studentët e programit të studimit bachelor në "Ekonomiks" zhvillojnë pas një viti praktikën në ciklin e dytë të studimeve master Profesional "Ekonomiks në

Sipërmarrje", kurse në ciklin e dytë Master Shkencor në Ekonomiks e zhvillojnë në vitin e dytë.

- Referuar gjurmimit të studentëve pjesa më e madhe punësohen pasi përfundojnë masterin apo gjatë periudhës që janë duke e ndjekur atë.
- Gjatë verës studentët përfshihen në praktika punësimi kryesisht nga marrëveshjet që ka Departamenti dhe universiteti me institucione publike, bankat e nivelit të dytë, si dhe aktivitete të tjera private të cilat adresojnë kërkesat e tyre apo në fakultet apo departament.
- Për më tepër cikli i studimeve bachelor nuk është ai që nxjerr studentët të gatshëm për tregun e punës, kjo është arsyeja që cikli i parë i studimeve bachelor shoqërohet domosdoshmërisht me diplomat e ciklit të dytë të studimeve si ato profesionale apo shkencore.

Argumenti i GVJ: kriteri është vlerësuar pozitivisht nga ana e GVJ. IAL i referohet rekomandimit në mënyrë të shkëpur nga vlerësimi që është dhënë në paragrafin e parë, që është: *"Nga shqyrtimi planit mësimor dhe syllabuseve rezulton që studentët mund të aftësohen jo vetëm për të kuptuar teoritë dhe parimet ekonomike, por dhe për të zgjidhur probleme të thjeshta në fushën e ekonomisë"*. Institucioni ka sjellë shumë argumenta për të kundërshtuar rekomandimin, por këto argumenta në opinionin tonë e bëjnë më të domosdoshme marrjen në konsideratë të këtij rekomandimi. Një argument tjetër që mbështet këtë rekomandim është dhe gjetja e raportit të analizës së pyetësorëve për pyetjen në lidhje me vështirësinë e përmbajtjes, ku 55.3 % e studentëve janë përgjigjur që janë dakort dhe totalisht dakort që **përmbajtja e mësimit ishte shumë e vështirë**. GVJ ka vlerësuar vetëm programin Bachelor dhe nuk ka marr në konsideratë planet mësimore të programeve Master. Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon që njësia bazë duhet të shoh me kujdesë planin mësimor dhe të bëj ndryshimet që mundësojnë përfitimin e aftësive dhe kompetencave nga ana e studentëve në fushat e nevojshme ¹, **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

3. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin III.1 Kriteri 4 "GVJ rekomandon që gjetjet e vlerësimit dhe masat e planifikuara për përmirësimin e cilësisë në mësidhënie mund të përfshihen në mënyrë të përmbledhur në raportin vjetor ku trajtohen problematikat mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë"**.

¹ <https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/>, fq. 6



Komenti i IAL: Referuar praktikës së ndjekur nga institucioni, përpilimi i këtyre dokumentacioneve nuk përkon në të njëjtën kohë. Konkretisht nëse i referohemi Evidencës II.14 Miratimi dhe përcjellja e Raportit Vjetor të Departamentit të Ekonomiksit, ky dokument është përpiluar më 20.09.2019, konform afateve të kërkuara, ndërkohë referuar shkresës Evidenca III.5-Kthim përgjigje për raportin e analizës dhe vlerësimit të pyetësorit, ky dokument është përpiluar më 08.01.2020, konform afateve të kërkuara.

GVJ konstatoi që vetëm personeli akademik dhe ndihmës-akademik informohet me rezultatet e vlerësimit dhe nuk evidentoi ndonjë instrument që këto gjetje të bëheshin publike për studentët apo grupe të tjera interesi.

Në përmbushje të kriterit dhe atë çka është shprehur GVJ, DSBCP argumenton NJSBCVI, si një prej strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, publikon në faqen e UV-së në mënyrë periodike raportin e analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë të mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, së bashku me rekomandimet përkatëse. Ky publikim respekton ligjin Nr.9888 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr.48/2012, për mbrojtjen e të dhënave personale.

Argumenti i GVJ: Raporti vjetor hartohet nga IAL dhe merr në konsideratë gjithë veprimtarinë përpara hartimit të tij. Pavarësisht afateve të raportimit NJSBCVI mund të përfshijë në raportin gjetjet e vlerësimit të fundit të realizuar. Ky rekomandim i jepet IAL për të evidentuar më mirë aktivitetin e NJSBCVI, për të përmirësuar cilësinë e raportit, dhe nuk është konsideruar si mos përmbushje e kriterit. Për konkluzionin e dytë GVJ konsultoi faqen e internetit të IAL dhe e ndryshon konkluzionin si më poshtë: "*GVJ konstatoi që personeli akademik dhe ndihmës-akademik informohet me rezultatet e vlerësimit dhe ata mund të shprehen në lidhje me to përpara se raporti të miratohet nga Senati Akademik. Raportet e analizës së pyetësorëve publikohen në faqen e internetit të UV dhe janë lehtësisht të aksesueshme për studentët apo grupe të tjera interesi*". **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

4. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin III.3 Kriteri 5:** "*GVJ sugjeron që Njësia kryesore duhet të bëjë kërkesa të vazhdueshme për rritjen e numrit të vëllimeve për literaturën bazë në bibliotekën e UV*".

Komenti i IAL: Referuar titujve të librave të përcjella nga Departamenti i Ekonomiksit gjeni bashkëngjitur komenteve shkresën "Përcjellje e projekt buxhetit për Departamentin e Ekonomiksit për vitin 2017-2018", faqe 5-6. Në këtë shkresë gjeni kërkesat për libra nga Departamenti i Ekonomiksit.

Argumenti i GVJ: Në raport është konstatuar që ka patur rritje të numrit të titujve dhe vëllimeve të fushës e ekonomisë. Në raport do të saktësohet që kjo ka ndodhur në periudhën 2016-2018. GVJ ka rekomanduar që kjo eksperiencë e mirë të vazhdojë dhe të shtohet numri i vëllimeve për titujt e literaturës së detyrueshme, mbështetur në një verifikim të bërë në bibliotekë gjatë vizitës në IAL. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

5. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin III.4 Kriteri 1:** *"Ndër të tjera GVJ komenton: "GVJ nuk konstatoi ndonjë ndryshim të madh në raportet e dy viteve akademike. GVJ rekomandon që NJSBCVI duhet të ndjekë në vijimësi zbatimin e rekomandime nga Njësitë bazë dhe zbatimi i tyre duhet të reflektohet në raportin e veprimtarisë së kësaj njësie (si pjesë e raportit vjetor)".*

Komenti i IAL: Në lidhje me komentin e GVJ-së, DSBCP argumenton: Në mënyrë të vazhdueshme institucioni monitoron zbatimin e planit të masave për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies. Strukturat e ngarkuara në Vendimin e Senatit përkatës të Planit të Masave për vitin akademik zbatojnë dhe raportojnë mbi përmbushjen e planit të masave duke i bërë pjesë integrale të raporteve të tyre të punës.²³ Njëkohësisht NJSBCVI, përcjellë pranë autoriteteve drejtuese të UV-së një raport të detajuar mbi realizimin e veprimtarive të parashikuara në këtë plan masash së bashku me evidencat përkatëse.⁴

Argumenti i GVJ: GVJ e ka evidentuar punën e bërë nga NJSBCVI. Komenti ka të bëjë me rezultatet e procesit dhe rekomandimi është në funksion të përmirësimit të rezultateve.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

6. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin III.4 Kriteri 4:** *"GVJ nuk arriti të evidentojë se si këto aktivitete kanë çuar në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. GVJ mendon që kualifikimi i vazhdueshëm mbështetur në nevojat duhet të jetë më sistematik dhe për këtë rekomandon që strategjia në këtë fushë të plotësohet me planin e aktiviteteve".*

Komenti i IAL: Sqarojmë në lidhje me pjesën e parë të këtij evidentimi: Duke iu referuar komenteve të cituara të studentëve si dhe përfundime të raportit, fq.125-126, konstatojmë se rezultatet e vitit akademik 2018-2019 kishin një përmirësim të dukshëm në krahasim me raportin e mëparshëm në përgjithësi për të gjitha degët e ofruara nga Departamenti i Ekonomiksit, përfshi këtu Bachelor në "Ekonomiks".

² Raport 6 mujor i NJSBCVI-së

³ Raport 3 mujor i NJSBCVI-së

⁴ Informacion mbi zbatimin e planit të masave 2017-2018

Sqarojmë në lidhje me pjesën e dytë të këtij evidentimi: se edhe Departamenti i Ekonomiksit e ka vlerësuar po ashtu përmirësimin e vazhdueshëm në këtë fushë. Për këtë arsye, çka është konstatuar dhe rekomanduar më sipër Departamenti i Ekonomiksit e ka përfshirë në objektivat e zhvillimit të këtij programi studimi, shoqëruar me planin e masave që synojnë të ndjekim, referuar. **Evidencës I.6-Plani Strategjik i programit të studimit Bachelor në Ekonomiks, fq.8-9.**

Argumenti i GVJ: Perceptimi i studentëve në lidhje me mësimdhënien nuk është i lidhur në pyetësor me kualifikimin e stafit në fushën e kërkimit. Nevojiten instrumenta të tjerë për të dokumentuar se si ka ndikuar kualifikimi në fushën e kërkimit shkencor në përmirësimin e mësimdhënies. Në evidencën I.6, objektivi 4 janë listuar disa masa, të cilat kanë nevojë të plotësohen me tregues, afate, persona përgjegjës dhe buxhete për tu konsideruar si plan. Komentet e IAL nuk e ndryshojnë vlerësimin. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

7. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin III.6 Kriteri 6:** *"GVJ mbështetur në evidenca konstatoi që institucioni ka parashikuar në të gjitha rregulloret dhe kodin e etikës masa për të shmangur kopjimin në provime dhe plagjaturën. Pedagogët e lëndës tërheqin vëmendjen e studentëve edhe përmes syllabuseve që nuk lejohet kopjimi i detyrave individuale, kopjimi në provim, mbajtja e telefonave celularë apo komunikimi në të gjitha format. Megjithatë GVJ nuk arriti që të evidentonte ndonjë praktikë, se si personeli akademik e realizon këtë në praktikë".*

Komenti i IAL: Sqarojmë se në lidhje me detyrat individuale, është më e lehtë realizimi i këtij kontrolli, për arsye të ndjekjes së vazhdueshme në auditor i përgatitjes së studentëve, si dhe për shkak të një komunikimi të vazhdueshëm të studentëve me pedagogun e lëndës, e cila krijon mundësi për monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së punës së çdonjërit prej studentëve të kursit.

Për sa i takon temave të diplomave, nuk ka patur të tilla, të paktën këtë periudhë 3 vjeçare, për arsye të mos-plotësimin nga ana e studentëve e kriterit të mesatares.

Në lidhje me provimet, studentët lajmërohen përmes rregullores, e cila citohet përpara se të fillojë provimi. Kjo bën që zbatimi fillimisht të bazohet në përgjegjësinë e tij personale. Por sqarojmë gjithashtu se provimet realizohen të mbështetura nga komisioni i provimit, sikurse sqaruar dhe përmes shkresës **Evidenca II.10-Kalendari i provimeve si dhe komisionet e provimeve, fq.6-9**, e cila tregon për prani të stafit mbështetës në çdo provim,

krahasuar me numrin e studentëve të kurseve të mbuluara nga Departamenti i Ekonomiksit.

Po ashtu gjatë provimit merren masa për distancën e konsiderueshme për të shmangur kopjimin si dhe bërja e disa tezave të ndryshme për të njëjtin grup provimi, si dhe hartimi i tezave në mënyrë të tillë që të përfshihen disa seksione ku një pjesë e konsiderueshme e zënë ushtrimet me zgjidhje dhe argumentim dhe një pjesë e vogël e seksionit alternativa dhe pohime. Kjo ndihmon në zvogëlimin e realizimit të provimit nga ana e studentit përmes kopjimit.

Argumenti i GVJ: Ekspertët bien dakort me të gjitha argumentat që IAL ka parashtruar për shmangien e kopjimit në provime dhe detyra individuale. Ndër format e vlerësimit në disa module janë dhe detyrat e kursit. Konkluzioni i dhënë në këtë kriter lidhet me instrumentat për shmangien e plagjaturës. Ky konkluzion do të plotësohet në raport si më poshtë: *Megjithatë GVJ nuk arriti që të evidentonte ndonjë praktikë, se si personeli akademik e realizon në praktikë shmangien e plagjaturës.* **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

8. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin III.6 Kriteri 9:** *"E drejta e studentëve për të ankimuar vlerësimin përfundimtar është e parashikuar në rregulloren e IAL dhe atë të PS. Dekani pasi informohet nga drejtuesi i njësisë bazë ngre një komision për të verifikuar pretendimet e studentëve, i cili bën dhe vlerësimin përfundimtar. Procesi i ankimit duhet të dokumentohet në çdo hap të tij sipas rregullores. GVJ në takimet me studentët dhe personelin akademik u informua që kjo praktikë zbatohet, por nuk pa ndonjë procedurë të dokumentuar".*

Komenti i IAL: Sqarojmë se nga studentët e degës Bachelor në "Ekonomiks" nuk ka patur raste të ankesave mbi rezultatet e provimit. Provimet ruhen një semestër në sekretari deri në ardhjen e semestrit pasardhës duke i bërë më të përgjegjshëm pedagogët në rritjen e transparencës së vlerësimit të studentëve. Ne e konsiderojmë këtë si një vlerë të Universitetit tonë.

Argumenti i GVJ: Ekspertët nuk kanë konstatuar mospërbushje të kriterit 9, por për vlerësimin e tij janë mbështetur vetëm në rregulloret dhe informacionin që kanë marr gjatë vizitës në IAL. Mungesa e një evidence që të dokumentonte procedurën e ndjekur nuk ka ndikuar në vlerësimin e përbushjes së këtij standardi **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

9. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin III.7 Kriteri 10**: "*Plani mësimor për këtë program studimi është hartuar mbështetur në eksperiencat e programeve të ngjashme në vendet të BE dhe universitetet me të cilat fakulteti ka bashkëpunuar në vite. Ky element mundëson rritjen e mobiliteteve të studentëve të UV në kuadër të programit Erasmus+, por ofrimi i programit vetëm në shqip nuk mundëson mobilitetet e studentëve në drejtim të UV. Referuar evidencave GVJ konstaton që studentët nuk e kanë shfrytëzuar këtë mundësi*".

Komenti i IAL: Sqarojmë se për Bachelor në Ekonomiks ofrohen shtatë lëndë në gjuhë të huaj, sikurse konfirmohet dhe prej dokumentit zyrtar "Katalogu i lëndëve të ofruara në gjuhë të huaj", fq.6.<https://univlori.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/SHQIP-Katalogu-i-1%C3%ABndC3%ABve-2019-2020.pdf>. Pra, nuk ka qënë ky element që ka penguar rritjen e mobiliteteve të studentëve të UV-së në kuadër të programit Erasmus+, thjesht nuk ka patur aplikime. Por ne do të vazhdojmë përpjekjet që studentët e kësaj dege të rrisin interesin e tyre.

Argumenti i GVJ: Institucioni ka sjellë për vlerësimin e këtij kriteri argumenta që u verifikuan nga GVJ. Linku i ofruar gjendet në faqen e UV. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

10. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin III.8 Kriteri 9**: "*Sipas RVB kopja e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar i vihet në dispozicion studentit vetëm me kërkesën e tij pasi është diplomuar. GVJ nuk gjeti ndonjë referencë në rregulloren e PS në lidhje me këtë kriter*".

Komenti i IAL: Sqarojmë se programi i studimit është në dispozicion të studentit në çdo moment, sapo ai logon në platformën UVMS, pasi e gjejnë të inkuorporuar në formë elektronike si pjesë e dokumentacionit informues brenda sistemit zyrtar UVMS.

Argumenti i GVJ: Vlerësimi i këtij kriteri është mbështetur në RVB dhe rregulloren e programit të studimit. Kriteri bën fjalë për kopje të plotë zyrtare të programit të studimit, pra jo për kopje elektronike. Konstatimi i ekspertëve që studenti pajiset vetëm me kërkesën e tij pasi është diplomuar nuk e ka influencuar vlerësimin për shkallën e përmbushjes së standardit. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

11. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin IV.2 Kriteri 4**: "*Sipas ligjeve në fuqi Departamenti i Ekonomiks planifikon kohën vjetore të punës sipas realizimit të procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe transferimit të dijeve. Sipas evidencave të*

dorëzuara për ngarkesën e stafit akademik për vitin 2019-2020, stafi i angazhuar në programin e Ekonomiksit mbulon orë mësimore në auditor që vijnë nga minimum 220 orë mesimore në maksimumin 465 orë mësimore për stafin PAE. GVJ gjykon që kjo ngarkesë është e lartë dhe mund të ndikojë negativisht në cilësinë e mësimdhënies”.

Komenti i IAL: Ju bëjme me dije se: ngarkesa në auditor e stafit akademik të Departamentit të Ekonomiksit është bazuar në legjislacionin në fuqi e konkretisht në pikën 4/a të Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 dhe Udhëzimit nr.37 datë 04.12.2018 pika a, dhe në asnjë rast nuk është shkelur legjislacioni në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu, argumentojmë se pranimi i ngarkesës mësimore ka ardhur si pasojë e fakteve të mëposhtme:

- 1) Çdo pedagog ka kërkuar dhe pranuar vete një ngarkesë të tillë.
- 2) Asnjë pedagog i dëgës sonë nuk është i angazhuar në mësimdhënie në universitete të tjera publike apo private, por i gjithë kontributi i tyre është pranë Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- 3) I gjithë stafi është i pajisur me gradën "Doktor" dhe cilësojmë se kanë të paktën experiencë në mësimdhënie 8 vjet.
- 4) Secili prej tyre jep mesim në lëndë të ngjashme me njera tjetrën dhe me kualifikimet shkencor dhe profesional të pedagogut.
- 5) Se fundi, duke përdorur matematikën e thjeshtë argumentojmë se ngarkesë bazë mësimore në auditor është 165 orë. Kjo ngarkesë së bashku me mbingarkesën, në rastet kur është maksimale, është: $465 / (2 \text{ sem} * 15 \text{ javë}) = 15,5$ orë në javë ose 3 orë leksione dhe seminare në ditë, çka argumentojmë se është plotësisht e përballueshme nga vet pedagogët.

Argumenti i GVJ: GVJ nuk konstatoi asnjë shkelje ligjore në lidhje me ngarkesën mësimore, as nuk argumentoi në lidhje me pranimin e ngarkesës nga stafi akademik, por shprehu gjykimin e tij në lidhje me nivelin e cilësisë së mësimdhënies në rastet e ngarkesës së lartë. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

12. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin IV.6 Kriteri 3:** *"Duke ju referuar RVB, institucioni i nënshtrohet auditimit financiar të jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe MASR. Duke ju referuar RVB-se po ashtu, në organigrame ka një Njësi Auditimi të Brendshme që prodhon raporte analitike financiare por institucioni nuk ka vënë në dispozicion ndonjë prej tyre. Dokumentacioni i vënë në dispozicion përmban akt-rakordime financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të nënshkruara nga Drejtoria e Financës dhe Thesarit. GVJ nuk konstatoi një raport auditimi të mirëfilltë”.*



Komenti i IAL: Në Universitetin e Vlorës monitorimi i veprimtarive të sektorëve realizohet prej Njesisë së Auditimit të Brendshëm, e cila është ngritur me Vendim Senati Nr. 8, datë 14.02.2019. Ajo ushtron veprimtarine e saj mbështetur në programin vjetor të sektorit. Për vitin akademik 2018-2019 janë realizuar tre auditime në sektorët:

1. Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional;
2. Drejtoria e Edukimit të Ciklit të Parë dhe të Dytë,
3. Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse, Sektori i Shërbimeve.

Për secilin prej sektoreve, të sipërcituar Njësia e Auditimit ka lënë rekomandime përkatëse për përmirësimin e punës dhe arritjen e objektivave të Institucionit duke u bazuar në kuadrin ligjor, detyrat dhe përgjegjësitë etj. Bashkangjitur raporti vjetor i Sektorit të Auditit të Brendshëm

Argumenti i GVJ: GVJ merr në konsiderate dokumentacionin e vënë në dispozicion gjatë aplikimit dhe vizitës në institucion, jo pas përfundimit të raportit. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

13. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin V.2 Kriteri 4:** *"Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomes dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e UV dhe në rregulloren e programit përkatës të studimit. Të dhëna për diplomimin gjenden edhe në faqen Web të UV-së. Për të mbështetur edhe më tej studentet, sugjerohet të përgatitet një udhëzim specifik mbi procesin e punimit të Diplomës".*

Komenti i IAL: Për sa i takon temave të diplomave, nuk ka patur të tilla, të paktën këtë periudhe 3 vjeçare, për arsye të mosplotësimit nga ana e studentëve të kriterit të mesatares. Gjithësesi sqarojmë se udhëzimi specifik mbi procesin e punimit të diplomës është disponibël, sikurse bazuar në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 76, datë 05.12.2016 "Për miratimin e Rregullores "Për krijimin, regjistrimin, ruajtjen, shërbimin, dorezimin e dokumenteve në Universitetin "Ismail Qemali ", Vlorë", Neni 9 pika 18 e tij, si dhe shtojcat e këtij vendimi fq.24 e në vazhdim. Për më tepër, fazat në të cilën përfshihet punimi i diplomës është i përfshirë në lëndën Shkrimi Akademik. Në lidhje me gjetjen e të dhenave, metodat dhe analizen e tyre, studentet e zhvillojnë në lëndën Statistik dhe Ekonometri. Përsa i përket zgjedhjes së temës dhe strukturës së saj, studenti komunikon në mënyrë të vazhdueshme me pedagogun udhëheqës sipas një kalendari specifik i miratuar nga të dyja palet.

Argumenti i GVJ: GVJ sugjeron që i gjithë informacioni më sipër të kombinohet në një dokument të vetëm për të udhëzuar specifikisht gjithë procesin administrativ dhe kërkimor në lidhje me punimin e diplomës. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

14. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin V.3 Kriteri 3:** *"Nga takimi që GVJ pati me Zyrën e Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit konfirmoi se është një zyrë e re e krijuar e cila akoma nuk ka mundur të japë rezultate të punës së saj. Mungesa e praktikës profesionale si kerkesë e detyrueshme e programit Bachelor në "Ekonomiks" nuk e lehtëson qasjen e studentëve me tregun e punës. Në këtë pikëpamje, institucioni akoma nuk mund të ofrojë informacion mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen e studentëve në tregun e punës. Po ashtu nuk janë arritur marrëveshje me aktorë lokale për të ofruar një mbështetje të tillë. Sugjerojmë që Zyra e Këshillimit dhe Alumni-t të intensifikojë përpjekjet e saj për të krijuar rrjetizimin e nevojshëm me aktorët lokale në përmbushje të këtij kriteri".*

Komenti i IAL: Për të mos rënë në përsëritje, çështjen në lidhje me mungesën e praktikës profesionale në planin mesimor e kemi sqaruar më sipër në komentin 2 për Standartin II.1 kriteri 4.

Argumenti i GVJ: GVJ në këtë kriter i referohet punës së Zyrës së Këshillimit dhe Alumni dhe jo mungesës së praktikës profesionale. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

15. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin V.5 Kriteri 4:** *"Ky pyetësor menaxhohet në mënyrë të pavarur nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe analiza e rezultateve i shkon Rektorit, i cili duke e përcjellë në Departament, urdhëron të përpilohet plani i masave përkatëse. GVJ konstatoi këtë proces nëpërmjet dokumentacionit të disponuar dhe takimit me Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. GVJ sugjeron që analiza që i përket stafit akademik të Departamentit të Ekonomiksit të përfshihet në raportin vjetor të tij, së bashku edhe me planin e masave (nëse ka)".*

Komenti i IAL: Për të mos rënë në përsëritje, çështjen në lidhje me sugjerimin që analiza që i përket stafit akademik të Departamentit të Ekonomiksit të përfshihet në raportin vjetor të tij, së bashku edhe me planin e masave, e kemi sqaruar më sipër në komentin 3 për Standartin III.I kriteri 4. Ky koment vlen edhe për konstatimin e bërë nga GVJ në lidhje me Standartin VI.2 kriteri 5. Gjithesesi bazuar në praktiken e kërkuar nga Institucioni ynë, caktuar me Vendim Senati "Vlerësimi i performancës së personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme", sipas të cilit përdoret ky dokument/formular për vlerësimin e

performancës së personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme të Universitetit "Ismail Qemali", Vlore, dhe ka për qëllim dhe objektiv kryesor përmirësimin e metodave të matjes së cilësisë së personelit akademik të institucionit, krijimin e të dhenave të përvitshme mbi performancën akademike të tyre si dhe ndërtimin e bazave, mekanizmave dhe argumenteve krahasuese në funksion të vlerësimit real dhe diferencues të kategorive të personelit akademik të UV-së, neve ju kemi vendosur në dispozicion Evidencën Shtese_Skeda e vlerësimit të performancës së stafit akademik.

Argumenti i GVJ: GVJ konstaton se në raportin vjetor të Departamentit përtej kërkesave ligjore duhet të përfshihen edhe të dhëna në lidhje me cilësinë në mësimdhënie si pjesë e integruar e përpjekjeve të Departamentit në përmirësimin e programit. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

16. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin VI.1 Kriteri 3:** *"Ndër të tjera GVJ komenton: Nga rishikimi dhe krahasimi i dy raporteve të viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 në lidhje me përfundimet e tyre, GVJ nuk vëren ndryshime të mëdha për sa i përket konkluzioneve të nxjerra nga analiza, veçanërisht për pikat e dobëta që lidhen me: vështirësitë e lëndëve, mosinkurajimi i mendimit kritik dhe diskutimit në klasë, mungesës së infrastrukture në auditore, laboratoreve didaktike dhe praktikave lidhur me programin".*

Komenti i IAL: Në lidhje me komentin e GVJ-së, DSBCP argumenton: Konstatimi i GVJ-se i referohet konkluzioneve në nivel Institucioni, ndërkohë që përsa i përket programit të studimit Bachelor në "Ekonomiks", në raportin e analizës së pyetësorëve për vitin akademik 2018-2019, NJSBCVI, në seksionin e rekomandimeve të programit të studimit (për më tepër jeni të lutur të referoheni fq. 125-126 të Raportit për Fakultetin Ekonomik) 5 ka realizuar një analizë krahasuese me rezultatet e dy viteve akademike. Në këtë analizë vlen për tu theksuar se ka një përmirësim të dukshëm në perceptimin pozitiv që studentët kanë ndaj programit të studimit në një sërë aspektesh, me konkretisht:

1. Gjate vitit akademik 2018-2019 krahasuar me vitin e mëparshëm akademik, kemi një rënie me 4.9% të studenteve që nuk ishin dakort me qëndrimin "Pedagogu ishte i qartë". (respektivisht nga 8.6 % në 3.7% për vitin aktual akademik.)
2. Nëse në vitin akademik 2017-2018, mesatarja aritmetike e studenteve të cilët ishin totalisht dakort dhe dakort me qëndrimin "Në Krahasim me Leksionet e tjera, m'u desh të lexoja më shumë" ishte 74.5%, për vitin aktual akademik kemi një rënie të

përqindjes së studentëve për po të njëjtat përgjigje në vlerën 63.1 %, pra një përmirësim i rezultatit me 11.4%.

3. Një tjetër rezultat pozitiv është rritja e dukshme prej 10 % të studenteve që ishin dakort dhe totalisht dakord me qëndrimin "Pedagogu inkurajonte dialogun/ diskutimin në klase." nga 82.2% në vitin 2017-2018 në 92.3% për vitin akademik 2018-2019.

Njëkohësisht nëse për vitin akademik 2017-2018, NJSBCVI ka rekomanduar si vijon: adaptimin e teknikave të mësimdhënies të orientuara më studentin në qendër, ku si pedagogu ashtu edhe studentët të luajnë një rol të caktuar në procesin e të mësuarit. Këto teknika do bëjnë që studentët tanë të jenë pjesëmarrës aktive dhe të ndërtojnë njohuri përmes bashkëveprimit, angazhimit dhe ndarjes së njohurive mes njeri -tjetri (për me tepër jeni të lutur t'i referoheni fq. 125-126 të Raportit për Fakultetin Ekonomik, fq. 50). Duke marrë në konsideratë përmirësimin e sipër cituar mbi inkurajimin e dialogut në auditor, ky rekomandim nuk është përfshirë në Raportin e Pyetësoreve për vitin akademik 2018-2019.

Argumenti i GVJ: Kriteri 3 referohet specifikisht: "Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.", pra i referohet institucionit dhe GVJ është përgjigjur në lidhje me këtë kriter në nivel institucional. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

17. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin VI.1 Kriteri 4:** "GVJ, ndër të tjera komenton: "Po ashtu, NJSBC harton raport të analizës së pyetësorëve, por jo një raport vjetor të aktivitetit të saj). "

Komenti i IAL: Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP komenton: NJSBCVI e organizon veprimtarinë e saj në bazë të një plani pune vjetor të miratuar dhe në mënyrë periodike si dhe raporton në mënyrë periodike për aktivitetin e saj pranë titullarëve të institucionit, ku hollësisht përshkruhen aktivitetet e realizuara në përputhje me planin vjetor të punës. Çdo aktivitet analizohet i detajuar për sa i përket periudhës së parashikuar, veprimtarive të ndërmara në kuadër të realizimit të tij, vështirësive të hasura si dhe niveli i përmbushjes së aktivitetit,(për me tepër jeni të lutur ti referoheni raporteve tremujore të NJSBCVI-së, bashkëlidhur). Njëkohësisht në mënyrë të përvitshme NJSBCVI përpilon Raportin vjetor të punës si pjese integrale të Raportit Institucional në përputhje me Udhëzimin e MASR Nr. 5 datë, 19.02.2018 II, si dhe raporton vazhdimisht mbi aktivitetet që organizon në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Nga sa më sipër vlen të theksohet se

Raporti i Analizës së Pyetësorëve mbi vlerësimin e Cilësisë së mësimdhënies është vetëm një prej raporteve të prodhuara prej këtij sektori.

Argumenti i GVJ: NJSBCVI nuk harton një raport vjetor të aktivitetit të saj. Raportet e punës të vendosura në dispozicion në këtë fazë nuk mund të merren parasysh. Ato mund të kombinohen në njëraport të vetëm vjetor. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

18. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin VI.2 Kriteri 3:** *"Ndër të tjera GVJ komenton: Me urdhër të rektorit nr. 123 dt. 19.12.2019 është ngritur një grup pune për përmirësimin e pyetësorit të studentëve i përbërë nga Dekanet dhe stafi akademik dhe i ngarkuar për të përmirësuar pyetësorin dhe për të hartuar një raport përmbledhës për Senatit Akademik".*

Komenti i IAL: Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP saktëson: Grupi i Punës i ngritur me Urdhër të Rektorit Nr. 123, datë 19. 12.2019 është i përbërë prej:

- a. Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional;
- b. Zv.Dekanët akademik për të katërt Njësitë kryesore;
- c. 1 (një) përfaqësues i stafit akademik për çdo Njësi Kryesore;
- d. 1 (një) përfaqësues i studentëve për çdo Njësi Kryesore;
- e. 1(një) përfaqësues i NJSBCVI-së;
- f. 1 (një) përfaqësues IT.

Njëkohësisht ju bëjmë me dije se tashmë me datë 17.01.2020 është mbajtur mbledhja e parë e grupit të punës. Bashkëlidhur gjendet procesverbali i mbledhjes.

Argumenti i GVJ: Komenti nuk është esencial për të ndryshuar vlerësimin e kriterit i cili kërkon specifikisht saktësimin nëse "Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

19. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin VI.3 Kriteri 3:** *"GVJ konstaton: Edhe pse në RVB përmendet se përgjegjësi i Departamentit kryen vëzhgime në auditor, nuk ka një instrument të posaçëm që përdoret nga institucioni për ta dokumentuar këtë. GVJ sugjeron pasurimin e përdorimit të metodave të drejtpërdrejta për sigurimin e cilësisë së programit të studimit".*

Komenti i IAL: Institucioni duke patur si synim parësor sigurimin e cilësisë së programit të studimit, ka si mjet matës kryesor pyetësorin e studenteve mbi mësimdhënien. Aktualisht është ngritur një grup pune për përmirësimin e këtij pyetësori në mënyrë që t'i përshatet me mirë politikave të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, sikurse referuar Urdhërit të Rektorit të UV, Nr. 123 dt. 19.12.2019 për "Ngritjen e grupit të punës për përmirësimin e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UV", të cilin po ia bashkëngjisë kësaj shkrese, si dokumentacion plotësues. Gjithashtu, referuar programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Ekonomiks, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes së cilësisë së këtij programi studimi, janë përdorur disa metoda të drejtpërdrejta, duke konsistuar në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të të mësuarit si dhe vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës.

Konkretisht për sa më sipër metoda të vlerësimit të drejtpërdrejtë janë:

1. Pyetësorët e përmendur edhe më sipër, drejtuar studentëve të cilet vlerësojnë nga ana e tyre cilësinë në mësimdhënie. (Evidenca K "Raporti mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve për vitin akademik 2017-2018". Evidenca L "Raporti mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve për vitin akademik 2018-2019"
2. Vlerësimi i performancës së personelit akademik me kohë të plotë të Departamentit të Ekonomiksit, sikurse Evidenca Shtesë_Skeda e vlerësimit të performancës së stafit akademik.
3. Literatura e miratuar në Departament në fillim të vitit akademik e cila përfshihet në syllabuset e lëndëve (Evidenca nr. 9-Miratimi dhe përcjellja e literaturës nga Departamenti i Ekonomiksit)
4. Vlerësimi i kurrikulës së studimit për të qenë konform ndryshimeve ligjore dhe për t'u përshtatur ndryshimeve të tregut. (Evidenca L9-Rishikim Plani dhe Përmirësim Kurrikule)
5. Evidenca përmbledhëse e realizimit të kohës vjetore të punës e firmosur nga Drejtuesi i Departamentit, Dekani, dhe personeli akademik bazohet në vëzhgimin në auditor të realizimit të leksioneve, seminareve, ushtrimeve, praktikës.
6. Regjistri personal i pedagogut të lëndës.

Argumenti i GVJ: GVJ i ka përmendur të gjitha metodat e mësipërme përgjatë raportit. Në këtë pikë i referohet pasurimit të metodave dhe dokumentimit të vëzhgimeve në auditor përmes një procesi të rregulluar. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

20. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin VI.5 Kriteri 4:** "Ndër të tjera GVJ komenton: "Në kuadër të sigurimit të cilësisë dhe të efektivitetit të veprimtarive institucioni ka ngritur Komision për planin e masave për përmirësimin e vazhdueshëm. Frytet e tij do të shfaqen në vijim, GVJ nuk mund të shprehet për momentin saktësisht në lidhje me arritjet e planit".

Komenti i IAL: Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP komenton: Në mënyrë të vazhdueshme institucioni monitoron zbatimin e planit të masave për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies. Strukturat e ngarkuara në Vendimin e Senatit përkatës të Planit të Masave për vitin akademik zbatojnë dhe raportojnë mbi përmbushjen e planit të masave duke i bërë pjesë integrale të raporteve të tyre të punës. Njëkohësisht NJSBCVI, ka përcjellë pranë autoriteve drejtuese të UV -së një raport të detajuar mbi realizmin e veprimtarive të parashikuara në këtë plan masash së bashku me evidencat përkatëse. Gjithashtu, monitorimi i planit të masave për përmbushjen e rekomandimeve të lëna prej Bordit të Akreditimit ka qenë një instrument i rëndësishëm për matjen e sigurimit të cilësisë dhe efektivitetit të veprimtarive institucionit në kuadër të rritjes së cilësisë së ofruar për programin e studimit.

Argumenti i GVJ: GVJ merr në konsideratë dokumentacionin e vënë në dispozicion gjatë aplikimit dhe vizites në institucion, jo pas përfundimit të raportit. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

21. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin VI.5 Kriteri 5:** "Ndër të tjera GVJ komenton: "Ndër veprimtaritë kryesore që institucioni ka ndërmarë në lidhje me ndërgjegjësimin dhe informimin e studenteve dhe personelit kanë qenë:

1. Përfshirja e stafit në trajnimet e ASCAL
2. Përfshirja e studentëve në pilotimin e pyetësorëve
3. Përfshirja e stafit akademik në fushatat e informimit të studenteve të sapo ardhur."

Komenti i IAL: Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ dhe në përmbushje të kriterit, DSBCP komenton: përpos aktiviteteve të përmendura më sipër në kuadër të rritjes së kulturës së Cilësisë, UV organizon:

1. Fushata informuese me studentë të UV-së në mënyrë periodike (Shkurt, Qershor) me qëllim përfshirjen e tyre në procesin e plotësimit të pyetësorëve të stafit akademik për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies;
2. Organizimi i takimeve informuese me studentët e sapo ardhur me qëllim njohjen e tyre mbi politikat dhe instrumentat që përdor Institucioni për Sigurimin e Cilësisë. Emërtimi i Aktivitetit : "Rëndësia e përfshirjes së studentëve në politikat e vlerësimit të UV-



së"19; publikimi në mënyrë të vazhdueshme në faqen e UV-së dhe rrjetet sociale të thirrjeve dhe njoftimeve të cilat kanë për qëllim përfshirjen e sa më shumë aktorëve në përmirësimin e cilësisë, përfshirjen në grupet Ad-Hoc të ngritura prej NJSBCVI-së të studenteve, stafit akademik, stafit ndihmës akademik etj,

Realizimi i një procesi të gjerë konsultimi me aktore të brendshëm me qëllim përpilimin e planeve të masave në kuadër të rritjes së cilësisë së programeve të studimit, të tilla si "Plani i masave pas rekomandimeve të lëna prej bordit të akreditimit, plani i masave për përmirësimin e programeve të studimit nëpërmjet analizës së pyetësorëve të studenteve etj".

Argumenti i GVJ: Komenti nuk është esencial për të ndryshuar vlerësimin e kriterit.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Ekonomiks”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i Studimit ka për qëllim përgatitjen e specialistëve në fushën e ekonomisë përmes sigurimit të njohurive të vazhdueshme, bashkëkohore, të përshtatshme me traditat kombëtare dhe standardet evropiane. Ky qëllim është në përputhje me misionin e UV për të formuar dhe përgatitur profesionistë në shërbim të zhvillimeve dinamike kombëtare, por dhe më gjerë, si dhe rolin dhe misionin e UV përcaktuar në statutin e IAL. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që PS i ofruar nga UV mbështetet dhe mbron vlerat kombëtare. [Evidenca I.6-Plani Strategjik i programit të studimit Bachelor në Ekonomiks, fq.4; Evidenca B-Plani Strategjik 2018-2024, fq.24; Evidenca A-Statuti i UV-së, fq.7, neni 3; Evidenca Shënimet]
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	IAL e mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në traditat më të mira kulturore, arsimore dhe shkencore të vendit. Ky është një parim i sanksionuar në statut dhe i konfirmuar gjatë vizitës në institucion në takimin me drejtuesit e njësisë kryesore dhe të njësisë bazë. [Evidenca A-Statuti i UV-së, fq.8, neni 5; Evidenca Shënimet]
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	UV ka në misionin e tij ofrimin e programeve të studimit në fusha të ndryshme në të tri ciklet e studimit, si dhe programe studimi me karakter profesional. Qëllimi i institucionit është nxitja e njohurive dhe shkencës përmes veprimtarisë akademike, punës kërkimore shkencore, aktivitetit krijues dhe bashkëpunimit më të tretët.GVJ, mbështetur në evidencat e UV si Statuti, Plani Strategjik 2018-2024dhe Rregullorja konstaton se PS Bachelor në "Ekonomiks" përputhet me fushën e veprimtarisë së institucionit, qëllimet dhe misionin e tij. [Evidenca A-Statuti i UV-së, fq.7-8, nenet 3-5; [Evidenca B-Plani Strategjik 2018-2024, fq.24; Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomi; Evidenca I.6-Plani Strategjik i programit të studimit Bachelor në Ekonomiks]

<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>UV ka vënë theksin dhe në dimensionin social të institucionit në Planin e tij Strategjik. IAL ndër të tjera synon të marrë një rol udhëheqës në ekonominë lokale dhe në zhvillimin kulturor të qytetit të Vlorës dhe më gjerë, si dhe të ndihmojë në përmbushjen e nevojave sociale, kulturore dhe zhvillimore të vendit. Ky dimension është mbajtur parasysh në hartimin e këtij PS, i cili është ideuar që të përmbush kërkesat e grupeve të interesit në nivel rajonal duke luajtur një rol të rëndësishëm në ekonominë lokale dhe zhvillimin kulturor të qytetit.</p> <p>[Evidenca B-Plani Strategjik 2018-2024, fq.24; Evidenca I.6-Plani Strategjik i programit të studimit Bachelor në Ekonomiks, fq.2]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2 Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në nivel institucional, si Plani Strategjik 2018-2024, Statuti i UV dhe dokumentacionit në nivelin e njësisë bazë si Strategjia dhe Plani Strategjik i Departamentit të Ekonomiksit, konstatohet se PS Bachelor në “Ekonomiks” është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit. [Evidenca A-Statuti i UV-së; Evidenca B-Plani Strategjik 2018-2024 Evidenca I.3-Strategjia e Departamentit të Ekonomiksit; Evidenca I.6-Plani Strategjik i programit të studimit Bachelor në Ekonomiks]</p> <p>Qëllimi dhe objektivat e këtij programi studimi janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të IAL, rregulloren e UV dhe të gjitha aktet e nxjerra për zbatimin e tij. [Evidenca I.4-Plani Mësimor i Programit Bachelor në Ekonomiks; Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomi]</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Në Statutin e UV përcaktohen drejtimit prioritare akademike të cilat janë në fushën e ekonomisë, shkencave humane, shkencave teknike dhe atë të shëndetit. Njësitë kryesore ofrojnë programe studimi të cikleve të ndryshme dhe fushat specifike të secilës Njësi kryesore përcaktohen në rregulloren e universitetit. [Evidenca A-Statuti i UV-së, neni 9]GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe gjatë takimit me drejtuesit e Njësisë bazë dhe Njësisë kryesore vlerëson se programi është ofruar dhe zbatohet duke u mbështetur në strategjinë e zhvillimit të institucionit, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore</p>

	qërregullojnëveprimtarinë e tij. [Evidenca Shënime]			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të institucionit.	Përmbajtja, struktura dhe organizimi i PS është hartuar në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi për programet e studimit të ciklit të parë. Dokumentat e PS si Plani mësimor i programit dhe Rregullorja e PS japin të dhëna të plota mbi strukturën dhe përmbajtjen e PS. Nga shqyrtimi i këtyre dokumentave GVJ konstaton se PS është organizuar në përputhje me drejtimet akademike të institucionit. [Evidenca I.4-Plani Mësimor i Programit Bachelor në Ekonomiks; Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomi, Kreu II, neni 3, fq.2]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Qëllimet dhe objektivat e PS janë të përcaktuara qartë në Planin Strategjik të programit. Plani përmban objektiva specifike lidhje me njohuritë e reja të fituara, pajisjen me aftësi dhe shkathtësi, si dhe kompetenca profesionale që fitojnë studentët në përfundim të PS dhe që synojnë futjen e tyre në tregun e punës. [Evidenca I.6-Plani Strategjik i programit të studimit Bachelor në Ekonomiks, fq. 3-4] GVJ konstaton që objektivat e PS janë të përcaktuara qartë, janë të përshtatshme për këtë cikël studimesh dhe bëjnë të mundur që studentët të formohen në përputhje me kërkesat e tregut.
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar [Evidenca RVB & Evidenca I.7-Studimi i Tregut të Punës] , GVJ konstatoi që Fakulteti i Ekonomisë ka realizuar një studim në nivel fakulteti në vitin 2011 " <i>Mbi ndikimin në punësim të kurrikulave të ciklit të parë të studimit</i> ". Në kohën e realizimit të studimit nuk ishte diplomuar akoma brezi i parë i studentëve të Ekonomiksit. Synimi i studimit ishte vlerësimi i përputhshmërisë së diplomave që lëshonte fakulteti me nevojat e tregut të punës. Në takimin me Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit, GVJ u informua që së fundmi është ndërmarrë një iniciativë për gjurmimin e studenteve në të gjitha programet e studimit në UV. GVJ u njoh më në detaje me këtë iniciativë në takimin me përfaqësues të Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e I & II. UV në mënyrë zyrtare

sektorin përkatës.	<p>iu është drejtuar institucioneve publike dhe private për grumbullimin e të dhënave për punësimin real të studentëve. Departamenti i Ekonomiksit ka realizuar gjithashtu së fundmi një anketë me 54 studentë të diplomuar dhe ka analizuar të dhënat. Të gjitha këto të dhëna janë të vlefshme dhe e ndihmojnë departamentin për të parashikuar ecurinë e programit në të ardhmen.</p> <p>[Evidenca Shënimet; Evidenca Informacion për GVJ]. <i>Megjithatë GVJ mendon që Departamenti duhet të fokusohet dhe në grumbullimin dhe analizën e të dhënave nga këndvështrimi i punëdhënësve.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit të studimit GVJ konstatoi se objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e PS janë të orientuara nga nevojat e tregut të punës. Në përfundim të studimeve programi i garanton studentëve përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që u mundësojnë atyre futjen në tregun e punës. Tregu i punës për studentët e diplomuar në këtë program është mjaft i gjerë. Ata mund të punësohen në sektorin publik, privat dhe atë jofitimprurës kryesisht si analist të dhënash, analist kredie në sektorin bankar, analist të dhënash në sektorin financiar, konsulent ekonomik, financiar apo menaxherial.</p> <p>[Evidenca I.4-Plani Mësimor i Programit Bachelor në Ekonomiks; Evidenca I.6-Plani Strategjik i programit të studimit Bachelor në Ekonomiks, pika 2].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>FE/UV është një nga Njësitë kryesore që e ka filluar veprimtarinë e vet me hapjen e këtij institucioni në vitin 1994. FE ka krijuar profilin e tij, i cili është konsoliduar gradualisht për t'iu përgjigjur zhvillime rajonale në përgjithësi dhe atyre në fushën e arsimit të lartë në veçanti. PS ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit në bashkëpunim me dy departamentet e tjera të FE.</p> <p>[Evidenca Organigrama FE/UV-së, https://univlora.edu.al/organigrama-fe/].</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë ka në përbërjen e tij për vitik akademik 2019-2020, 33 personel akademik efektiv (PAE) dhe 13 personel akademik me kontratë (PAK). Ndërsa Departamenti i</p>

	<p>Ekonomiksit ka 7 PAE dhe 2 PAK. Përbërja e personelit akademik (PAE&PAK) të fakultetit sipas gradave dhe titujve është: 22 me gradën Dr.; 16 të kategorisë profesor, 2 Dr. në proces dhe 6 Msc. PAE përbën rreth 72% të numrit të përgjithshëm të stafit akademik, ndërsa stafi me tituj dhe grada është 82.6% e numrit të përgjithshëm [RVB tabela 1.1, fq.101]. Evidencat e dorëzuara dëshmojnë qëmësimdhënia në këtë PS realizohet pothuajse tërësisht nga PAE, i kualifikuar dhe i angazhuar në mësimdhënie në përputhje me gradat dhe titujt akademikë. Departamenti i Ekonomiksit në mënyrë të veçantë mbulon pjesën më të madhe të programit, ka në përbërjen e tij staf me kohë të plotë që në pjesën më të madhe i ka kryer studimet e ciklit të dytë dhe të tretë në fushën e Ekonomiksit. Një pjesë e stafit ka qënë përfshirë gjithashtu në specializime afatgjata dhe afatshkurtëra në universitete perëndimore. [RVB, tab.12, fq.119, Evidenca II.12-CV e stafit akademik dhe ndihmës për programin e studimit Bachelor në Ekonomiks; Evidenca II.8-Kapacitetet fizike dhe akademike]</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Departamenti i Ekonomiksit në bashkëpunim dhe me dy departamente e tjera të FE kanë kapacitetet, përvojën dhe burimet e nevojshme në fushën akademike për të ofruar këtë PS.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Ekonomiks” është program studimi i ciklit të parë, që i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ky është një program studimi i fushës së shkencave ekonomike, me drejtim specifik në Ekonomiks. GVJ konstaton që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit (Fakulteti i Ekonomisë). [Evidenca A- Statuti i UV-së, neni 9, pika 4, neni 10; Evidenca I.2-Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit, neni 2]</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Ekonomiks” ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit, pranë Fakultetit të Ekonomisë. Departamenti i Ekonomiksit ofron vetëm diploma në Ekonomiks në të dy ciklet e studimit. GVJ konstaton që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë (Departamentit të Ekonomiksit), përgjegjëse për këtë PS. [Evidenca A- Statuti i UV-së, neni 9, pika 4, neni 10; Evidenca I.2-Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit, neni 2].</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Detyrat dhe përgjegjësitë mbi hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e PS janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e UV, si dhe në Rregulloren e Departamentit.</p> <p>[Evidenca A- Statuti i UV-së . kreu II dhe III; Evidenca C-Rregullore UV-së e ndryshuar;Evidenca I.2-Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit]</p> <p>Detyrat dhe përgjegjësitë janë të ndara dhe të harmonizuara midis strukturave organizative, organeve dhe autoriteteve drejtuese. Sipas këtij dokumentacioni është departamenti ai që propozon programet e studimit, harton planet mësimore, propozon kriteret e pranimit dhe përzgjedh studentët fitues.</p> <p>[Evidenca A- Statuti i UV-së , neni 10]</p> <p>GVJ konstatoi që ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara më së miri në aktet rregullatore. Njësia bazë ka peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e PS dhe kjo sigurohet përmes roleve dhe përgjegjësisë të qarta që kanë përgjegjësi i njësisë bazë, përgjegjësit e gruplëndëve/koordinatorët dhe titullarët e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor UV ka formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor UV ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë universitete në rajon, Evropë dhe SHBA, të cilat janë shfrytëzuar për kualifikimin e stafit akademik, stafit ndihmës-akademik, zhvillimin e punës kërkimore shkencore, shkëmbimin e përvojave dhe mobilitetin e studentëve.</p> <p>[Evidenca I- Raporti vjetor i UV për vitin 2017-2018, pika II, fq. 8-20; https://univlora.edu.al/2019/10/18/thirrje-per-bursa-studimi-per-studentet-erasmus/].</p> <p>UV është antarësuar gjithashtu në disa rrjete akademike, ç'ka i ka mundësuar shkëmbimin e përvojave, bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor, pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme, etj.</p> <p>[Evidenca I- Raporti vjetor i UV per vitin 2017-2018, pika II, fq. 20-23].</p> <p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në IAL konstatoi që Departamenti i Ekonomiksit është i përfshirë si përfitues në një pjesë të këtyre marrëveshjeve dhe projekteve, dhe kjo e ka ndihmuar në realizimin e objektivave të procesit</p>




	mësimor dhe formues të studentëve.			
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	<p>Departamenti i Ekonomksit harton dhe miraton një raport vjetor pjesë përbërëse e të cilit është dhe analiza e produkteve nga projektet e fituara, pjesëmarrja në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunimet me institucione të tjera në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, etj. Raporti i Departamentit bëhet pjesë e raportit vjetor të Njesisë kryesore dhe të IAL-së.</p> <p>[Evidenca II.14-Miratimi dhe përcjellja e Raportit Vjetor të Departamentit të Ekonomksit; Evidenca J- Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019, fq. 94-95].</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi që analiza është e fokusuar më shumë në nivel produkteve dhe jo në rezultatet e bashkëpunimeve dhe rekomandon që në të ardhmen të reflektohen në raportet periodike përfitimet në funksion të PS-it nga zbatimi imarrëveshjeve dhe bashkëpunimet.</p>			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	<p>Praktika profesionale nuk është pjesë e kurrikulës për PS Bachelor në “Ekonomiks”. Në takimin me drejtuesit e Njesisë kryesore dhe njesisë bazë GVJ u informua që institucioni ka marrëdhënie zyrtare dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës në programet e ciklit të dytë që mbulohen nga Departamenti i Ekonomksit.</p> <p>[Evidenca Shënime]</p>			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkëpunim me punëdhënësit.	<p>UV ka sanksionuar në Statut, Qendrën studimore ndërdisiplinore [Evidenca A- Statuti i UV-së, neni 12] e cila ndër të tjera duhet të organizojë aktivitete të edukimit dhe trajnimit të vazhdueshëm për studentët. Nga dokumentacioni dhe vizita në IAL GVJ konstatoi që nuk ka ndonjë ofertë të tillë për studentët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në Ekonomiks. <i>GVJ sugjeron që Qendra në të ardhmen të bëjë pjesë të programeve të saj dhe trajnimin për këtë grup studentësh.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Plani mësimor për PS Bachelor në "Ekonomiks"përmban 29 module dhe punimin e diplomës, ka 180 kredite dhe organizohet në 6 semestra. Të gjitha modulet kanë të përcaktuar ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, si dhe numrin e krediteve. Plani mësimor gjithashtu harmonizon më së miri peshën ndërmjet tipeve të veprimtarive. Dokumentacioni mbi PS pasqyron kërkesat sipas Ligjit nr.80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018. Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur GVJ konstatoi që PS është organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). [RVB tabela, 9-10, fq.114-115; Evidenca I.4-Plani Mësimor i Programit Bachelor në Ekonomiks; Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks]</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Plani mësimor përmban moduletë cilat synojnëdhënien e njohurive dhe shprehive në fusha të veçanta si Ekonomiksi, Financa, Kontabiliteti dhe Menaxhimi. Kjo realizohet kryesisht përmes lëndëve bazë dhe atyre ndërdisiplinore. Mbështetur në planin mësimor, syllabuset e lëndëve, takimet me personelin akademik dhe studentët GVJ konstatoi që PS synon formimin e shprehive të veçanta në disa specialite dhe fusha. Në opinionin e GVJ kjo qasje jo vetëm iu mundësonstudentëve marrjen e njohurive bazënë disa specialitete, por lehtëson punësimin e tyre si specialist në fusha tëndryshme , si dhe siguron lëvizshmërinë e studentëve në programet e ciklit të dytë. [RVB tabela 9, fq. 114]. Evidenca I.4-Plani Mësimor i Programit Bachelor në Ekonomiks; Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset), Evidenca Shënimit]</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Plani mësimor përmban 10 module në grupin e lëndëve karakterizuese, të cilat japin njohuri të thelluara në fushën e ekonomiksit. Plani parashikon gjithashtu dhënenin e njohurive në matematikë të përgjithshme dhe të zbatuar (në fushën e ekonomiksit dhe financës), statistikë dhe ekonometri të cilat i ndihmojnë studentët të kuptojnë dhe analizojnë modele të ndryshme ekonomike, të realizojnë punë të pavarur, të shprehin qëndrimin e tyre në lidhje me teori dhe shkolla të ndryshme ekonomike. Nga shqyrtimi i syllabuseve rezultoi që studentët mund të aftësohen jo vetëm për kuptimin e teorive dhe parimeve ekonomike, por dhe për të zgjidhur problema të thjeshta në fushën e ekonomisë. [Evidenca I.4-Plani Mësimor i Programit Bachelor në Ekonomiks; Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset)]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të</p>	<p>Nga shqyrtimi planit mësimor dhe syllabuseve rezultoi që studentët mund të aftësohen jo vetëm për të kuptuar teorinë dhe parimet ekonomike, por dhe për të zgjidhur probleme të thjeshta në fushën e ekonomisë. Këto aftësi dhe kompetenca merren kryesisht në disa module të ekonomiksit si Politikat e Zhvillimit Ekonomik, Historia e Mendimit Ekonomik, Ekonomiksi</p>

<p>paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Monetar, Ekonometria, etj. [Evidenca I.4-Plani Mësimor i Programit Bachelor në Ekonomiks; Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset); Evidenca Shënimit]. <i>Në mënyrë që plani mësimor të jetë më shumë i orientuar drejt aftësive dhe kompetencave GVJ sugjeron që të bëhen ndryshime të vogla në lëndët karakterizuese dhe lëndët plotësuese brenda kufirit të 20%, me lëndë që i japin studentëve aftësi dhe kompetenca në fusha të ndryshme. Këto ndryshime duhet të marrin në konsideratë dhe planet mësimore të programeve të studimit të ciklit të dytë që ofron njësia bazë. GVJ sugjeron gjithashtu futjen e praktikës profesionale në planin mësimor.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet me drejtuesit e Njesisë kryesore dhe Njesisë bazë rezultoi që PS respekton të gjitha elementet sipas përcaktimeve në VKM 41, datë 24.01.2018. PS realizohet në 6 semestra me 30 ECTS secili. Ngarkesa në auditor është 21 orë/javë për 5 semestra dhe 17 orë/javë në semestrin e gjashtë. Plani mësimor përmban 29 lëndë dhe punimin e diplomës. Sipas numrit të ECTS-ve lëndët grupohen si më poshtë: 3 lëndë me 4 kredite, 3 lëndë me 5 kredite; 14 lëndë me 6 kredite dhe 7 lëndë me 7 kredite. Komponentët mësimor janë të pasqyruara në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve. [RVB tabela 9, fq. 114; Evidenca I.4-Plani Mësimor i Programit Bachelor në Ekonomiks; Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset); Evidenca Shënimit] GVJ është i mendimit që konvertimi i ECTS-ve në orë mësimore dhe komponentë mësimor është në përputhje me aktet nënligjore dhe i pasqyruar saktë.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Në planin mësimor janë pasqyruar të gjitha ndarjet sipas veprimtarive formuese (nga A-E). GVJ konstaton që pesha e secilës veprimtari ndaj totali është si më poshtë: - lëndët bazë (kategoria A) kanë 18% të krediteve; - lëndët karakterizuese (kategoria B) kanë 55% të krediteve; - lëndët integruese (kategoria C) kanë 14% të krediteve; - lëndët plotësuese (kategoria D) kanë 10% të krediteve; - detyrimet përmbyllëse (kategoria E) kanë 3% të krediteve. [RVB tabela 9, fq. 114; Evidenca I.4-Plani Mësimor i Programit Bachelor në Ekonomiks] GVJ konstaton që kategoritë e veprimtarive formuese janë në përputhje me përcaktimet dhe kufijtë orientues të VKM 41 dhe ka hapësira për ndryshime të vogla për të përfshirë në PS praktikën profesionale. Grupimi i lëndëve sipas veprimtarive formuese është i përshtatshëm për këtë program studimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	UV përbëhet nga 4 njësi kryesore, një ndër të cilat është dhe Fakulteti i Ekonomisë. Departamenti i Ekonomiksit është një nga 3 njësitë bazë të Fakultetit të Ekonomisë dhe ofron këtë program studimi. [Evidenca A- Statuti i UV-së, nenet 9-10]. UV është akredituar institucionalisht me vendimin e BA, nr.71, datë 21.09.2017. PS Bachelor në“Ekonomiks” akreditohet për herë të parë.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, si dhe në zbatim të Statutit dhe Rregullores së UV, Departamenti i Ekonomiksit ka emëruar koordinatorin e programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e PS. Koordinatori ushtron njëkohësisht dhe veprimtari të tjera si: informon dhe orienton studentët e vitit të parë, kryen promovimin e PS, informon, orienton dhe këshillon studentët për veprimtarinë mësimore dhe aktivitete të tjera, ofron këshillim për zhvillimin karriere, etj. [Evidenca A- Statuti i UV-së, neni 77; Ev.C, neni 85; Evidenca II.3- Koordinatorët e programeve në Departamentin e Ekonomiksit] GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi që megjithëse një rol i ri, veprimtaria e koordinatorit vlerësohej nga drejtuesi i njësisë bazë dhe studentët.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga tre njësi bazë (Departamenti i Ekonomiksit, Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit). Sipas Statutit në fakultet duhet të funksionojë dhe qendra e kërkimit shkencor, por në RVBkjo njësi nuk del aktive. [Evidenca A- Statuti i UV-së, nenet 11-11; RVB, tab. 1.1] Departamenti i Ekonomiksit ofron programe të ciklit të parë dhe të dytë. Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe njësisë bazë janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e UV. GVJ konstatoi që organizimi i njësisë kryesore/bazë është në përputhje me ligjin Nr 80/2015 "Për arsimin e lartë".
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Fakulteti i Ekonomisë ka në përbërjen e tij 33 PAE. Dekani i Fakultetit ka titullin profesor. Shpërndarja e personelit sipas njësive bazë: Departamenti i Ekonomiksit përbëhet nga 7 PAE, nga të cilët 1 është në kategorinë profesor, 5 kanë gradën Dr. dhe 1 është Dr. në proces. Departamenti është i organizuar si një grup mësimor. Përgjegjësja e Departamentit ka gradën Dr. Departamenti i Menaxhimit përbëhet nga 16 PAE, nga të cilët 1 është në kategorinë profesor, 9 kanë gradën Dr. dhe 1 është Msc. Departamenti është i organizuar në dy grupe mësimore. Përgjegjësja e Departamentit ka titullin Prof.As. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit përbëhet nga 10 PAE, nga të cilët 1 është në kategorinë profesor, 6 kanë gradën Dr. dhe 3 janë Msc. Departamenti është i organizuar në dy grupe

	<p>mësimore. Përgjegjësja e Departamentit ka titullin Prof.As. Fakulteti Ekonomisë aktivizon në mësimdhënie dhe PAK, të cilët kanë statusin të ftuar ose staf akademik me kohë të pjesëshme. PA i ftuar është me tituj dhe grada shkencore.</p> <p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstatoi që njësia kryesore/bazë për PS përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik për të gjithë periudhën 2016-2020.</p> <p>[RVB, tab. 1.1, 1.2, 1.3. 1.4; Evidenca II.2-Grupi Mësimor Kërkimor Shkencor i Departamentit të Ekonomiksit]</p>			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive kryesore dhe njësive bazë janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e UV. GVJ konstatoi që organizimi i njësive kryesore/bazë është në përputhje me ligjin Nr 80/2015 "Për arsimin e lartë".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Mbështetur në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin AMS dhe në vizitën në IAL, GVJ konstatoi që njësia kryesore dhe ajo bazë kanë dokumentacion të plotë për organizimin e këtij PS si: rregullorja e departamentit, rregullorja e programit të studimit, plani mësimor, ngarkesa mësimore e personelit akademik, syllabuset e lëndëve, etj. [Evidenca I.2-Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit; Evidenca I.4-Plani Mësimor i Programit Bachelor në Ekonomiks; Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks; Evidenca I.8-Ngarkesa Mësimore e Departamenti i Ekonomiksit; Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset)].</p> <p>GVJ konstatoi gjithashtu që ky informacion është i përditësuar duke reflektuar të gjitha ndryshimet në zbatim të ligjit nr.80/2015 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.</p>
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Plani mësimor është organizuar në lëndë (29 lëndë) dhe në detyrime përmbyllëse (diploma). Lëndët janë të organizuara në katër kategori formuese (A-D). Organizimi i lëndëve në veprimtari formuese është bërë në përputhje me VKM Nr. 41 [RVB tabela 9, fq. 114, Evidenca I.4-Plani Mësimor i Programit Bachelor në Ekonomiks]
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë	Kohëzgjatja e PS është 3 vjet, 6 semestra dhe 180 ECTS. Kreditet janë 30 ECTS për semestër ose 60 ECTS për vit akademik.

e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit, për çdo lëndë ka të përcaktuar kategorinë të cilës i përket lënda, numrin e krediteve sipas sistemit ECTS, vitin dhe semestrin kur lënda zhvillohet. Lëndët e programit të studimit kanë 4, 5, 6 ose 7 kredite. Mbrojtja e diplomës ka 6 kredite. GVJ konstatoi që organizimi i PS është në përputhje me ligjin Nr.80/2015 dhe VKM 41. [RVB tabela 9, fq. 114]			
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Plani mësimor përmban informacion të plotë për ndarjen e lëndëve në leksione/seminare, orët në auditor/dhe jashtë auditorit, si dhe kreditet për çdo veprimtari. Në syllabuset e lëndëve ka informacion të plotë mbi detyrimet për frekuentim nga ana e studentëve dhe format e kontrollit të dijeve. Kontrolli i dijeve realizohet në mënyrë të vazhdueshme. GVJ konstatoi që plani mësimor përmban informacion të plotë. [RVB tabela 9, fq. 114; Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset)].			
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në rregulloren e PS janë të përcaktuara kriteret që duhet të plotësojnë studentët për t'u pranuar në këtë program studimi, kushtet për ndërprerjen apo transferimin e studimeve, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e tyre. [Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor ne Ekonomiks, nenet 4-6]			
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit përmban syllabuset për të gjitha lëndët e planit mësimor. Mbështetur në dokumentacionin e ngarkuar në AMS, GVJ konstatoi që syllabuset janë përditësuar bazuar në modelin e përcaktuar me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (pika 2.8, shtojca nr.2). Syllabuset përmbajnë informacion mbi rezultatet e të nxënit, konceptet kryesore, temat, literatura, frekuentimi dhe format e vlerësimit, numrin e krediteve, ngarkesën në auditor të ndarë në veprimtari. GVJ konstatoi se të gjitha syllabuset përmbajnë informacionin e nevojshëm. [Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset)]			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Përmbajtja e programit të studimit është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet janë kushtëzuar dhe nga hyrja në fuqi e ligjit nr.80/2015 dhe akteve nënligjore, por jo vetëm. Nevoja për ndryshime dhe përmirësime është diktuar dhe për të mundësuar lëvizshmërinë e studentëve në universite brenda vendit dhe në kuadër të programeve Erasmus+. GVJ konstatoi që rishikimi i programit të studimit është një proces ku përfshihen personeli akademik, autoritetet dhe strukturat drejtuese. Procesi është i dokumentuar sipas rregulloreve të institucionit. [RVB tab.11, fq. 116-118; Evidenca I.9-Rishikim Plani dhe Përmirësim Kurrikule; Evidenca Shënimet].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.4
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Mbështetur në dokumenatcionin e ngarkuar në AMS, GVJ konstaton që PS është strukturuar në 6 semestra me 30 ECTS për çdo semestër. Në total për çdo semestër ka 630 orë në auditor dhe 870 orë studim individual. Ngarkesa mësimore javore në auditor është 21 orë për 5 semestrat e parë, dhe 17 orë në javë për semestrin e gjashtë (këto përfshihet diploma). Struktura e vitit akademik përcaktohet sipas udhëzimeve të MASR dhe shpallet përpara fillimit të vitit akademik nga Rektori. GVJ konstatoi që ngarkesa e PS është strukturuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>[RVB, tab.9, fq.112; Evidenca I.4-Plani Mësimor i Programit Bachelor në Ekonomiks; Evidenca II.5-Orari Mësimor i Fakultetit të Ekonomise Vjeshtë 2016 - Vjeshtë 2019; Evidenca II.11-Kalendari Akademik per vitin akademik 2019 - 2020 Bachelor; Evidenca II.12-CV e stafit akademik dhe ndihmës për programin e studimit Bachelor në Ekonomiks].</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që programi është i fokusuar dhe ka përputhshmëri midis emërtimit të veprimtarive dhe lëndëve që përmban çdo veprimtari.[RVB tab 9, fq.114; Evidenca I.4-Plani Mësimor i Programit Bachelor në Ekonomiks].</p> <p>Shpërndarja e lëndëve në semestra dhe vite akademike mban në konsideratë ndërvarësinë midis lëndëve të ndryshme, dhe është në funksion të thellimit të njohurive dhe aftësimit të studentëve për studime në ciklin e dytë/ose punësimin e tyre në sektorin publik dhe privat.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.</p>	<p>Plani mësimor parashikon realizimin e 5 lëndëve në çdo semestër. Shpërndarja e lëndëve në semestra dhe orët mësimore në dispozicion të secilës lëndëmundësojnëpajisjene studentëve me njohuri për të kuptuar dhe interpretuar konceptet, parimet dhe modelet ekonomike, si të aplikojnë metodat sasiore dhe cilësore për të analizuar probleme të ndryshme ekonomike, të kuptojnë, interpretojnë dhe përdorin në jetën e përditëshme tregues të ndryshëm ekonomikë, të aplikojnë metoda të ndryshme dhe të interpretojnë gjetjet përmes grafikëve, tabelave, etj. Kreditet për</p>




	<p>çdo lëndë dhe ndarja e tyre midis leksioneve/seminareve mban në konsideratë vëllimin e njohurive të reja dhe aftësive që duhet të marrin studentët, si dhe karakterin aplikativ të tyre. GVJ mendon që pajisja e studentëve me këto njohuri dhe aftësi mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit, të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional të tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>PS është hartuar duke mbajtur në konsideratë programe të përfaqësuara kombëtare dhe ndërkombëtare. Lëndët, emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit për të gjitha tipet e veprimtarive dhe në pjesën më të madhe të tyre i njëjtë me PS të ngjajshme. Ngarkesa e punës së studentit është shpërndarë në mënyrë uniforme gjatë të tri viteve akademike.</p> <p>[RVB tab.9, fq.114, tab.10 fq. 115-116; Evidenca Shënimit]</p> <p>GVJ mendon që struktura e programit, lëndët, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë janë në përputhje me profilin e programit dhe të përfaqësuara me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Veprimtaritë formuese që zbatohen për këtë program studimit janë leksionet dhe seminarët. Ndarja e orëve midis leksioneve dhe seminare është përcaktuar mbështetur në numrin e ECTS-ve si dhe karakterin formues të lëndës. Në varësi të lëndëve dhe orëve që kanë në dispozicion ndarja në formim teorik dhe praktik është në raportet 3/2; 3/1; 2/2 dhe 2/1. GVJ mendon që kjo ndarje mundëson përvetësimin e njohurive, arritjen e objektivave formues, lehtëson transferimin e studimeve brenda dhe jashtë vendit, mundëson mobilitetin e studentëve dhe i aftëson ata për të hyrë në tregun e punës.</p> <p>[RVB tab.9, fq.114, Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset); Evidenca Shënimit]</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve (syllabuset) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme nga titullarët e lëndëve dhe miratohen nga njësia bazë. Ndryshimet e miratuara i përcillen njësisë kryesore. Gjatë takimit me PAE GVJ u informua që ndryshimet zakonisht realizohen para fillimit të vitit akademik ose në fundin e vitit paraardhës. GVJ konstatoi që të gjitha programet e lëndëve janë përditësuar sipas formatit të VKM 41/shtojca 2. Literatura e detyruar dhe ndihmëse është përditësuar, por në rastin e literaturës shqip kushti i 5 viteve të fundit nuk mund të realizohet për të gjitha lëndët. Pavarësisht kësaj GVJ mendon që literatura e përzgjedhur për çdo lëndë është literatura e përshtatshme.</p> <p>[Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset); Evidenca Shënimit].</p>

<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ është i mendimit që përmbajtja e PS garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synohen për një program studimi të ciklit të parë.</p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që përmbajtja e PS Bachelor në “Ekonomiks” iu mundëson studentëve të ndjekin studimet e ciklit të dytë në fushën e Ekonomiksit (Master Shkencor dhe profesional). Gjatë takimit me GVB u theksua që studentët e diplomuar në ciklin e parë në Ekonomiksmund të ndjekin gjithashtu studime të ciklit të dytë dhe në fushën e menaxhimit, financave apo kontabilitetit, pasi programet e studimit kanë lëndë të përafërta. Formimi i studentëve përshtatet gjithashtu me nevojat e tregut tëpunës në disa profile në sektorin privat dhe publik. [Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset); Evidenca Shënime]</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Përmirësimet në PS kanë si shtysë përshtatjen me kërkesat e tregut të punës. Strukturat drejtuese të njësisë bazë dhe njësisë kryesore për të realizuar këto ndryshime kanë marrë në konsideratë opinionet dhe propozimet e institucioneve me të cilat bashkëpunojnë, ekspertët e jashtëm, si dhe opinionin e Alumni. [RVB, Evidenca Shënime]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas RVB në këtë PS për vitin akademik 2019-2020 japin mësim 29 personel akademik (27 PAE dhe 2 PAK), nga të cilët 1 është i kategorisë Prof, 5 Prof. As., 12 janë me gradën Dr., 3 doktorant në proces dhe 8 janë me Msc [RVB, tab.6.1, fq.107 dhe tab 7, fq.113]. Ngarkesa e programit të studimit për vitin akademik 2019-2020 realizohet nga stafi PAE në masën 97 % (1720 orë) dhe nga ai PAK në masën 4.9 % (90 orë).Ngarkesa e stafit të programit të studimit me kohë të plotë nivel IAL-je, luhet nga 480 orë maksimalia në 210 orë minimalia. [RVB, tab. 12.1; Evidencë Tabela 4, e marrë pas vizitës në IAL].</p>

	<p>GVJ gjatë vizitës në IAL u takua me një pjesë të madhe të personelit akademik dhe konstatoi që i gjithë personeli i angazhuar në këtë PS përmbush kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>[Ligji Nr. 80/2015, neni 9, pika 6]</p>			
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në të dhënat e RVB 93 % e personelit akademik që jep mësim në këtë PS është PAE. Nga këta 26.9% janë PAE në Departamentin e Ekonomiksit, të cilët mbulojnë ngarkesën më të madhe në këtë PS. Të tjerët janë PAE në dy departamentet e tjera të njësisë kryesore. GVJ konstatoi që i gjithë personeli akademik i përfshirë në mësimdhënie në këtë PS ka nivelin e kërkuar të kualifikimit dhe angazhim maksimal për zbatimin e PS.</p> <p>[RVB, tab.12, fq.119; Evidenca II.12-CV e stafit akademik dhe ndihmës për programin e studimit Bachelor në Ekonomiks].</p>			
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë PS mbulon lëndë që përputhen me fushën e tyre akademike dhe kërkimore. Nga shqyrtimi i CV të personelit akademik GVJ konstatoi që pjesa më e madhe e tyre kanë kryer studimet e ciklit të dytë dhe të tretë në fusha që përkojnë me lëndën/lëndët që mbulojnë në këtë PS. Gjithashtu veprimtaria e tyre kërkimore pas doktorature përputhet me specifikën e lëndëve që ata mbulojnë në PS.[Evidenca II.12-CV e stafit akademik dhe ndihmës për programin e studimit Bachelor në Ekonomiks].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Plani mësimor nuk parashikon praktika profesionale në këtë program studimi. Gjithashtu në planin mësimor është parashikuar provim diplome mbi bazën e pyetjeve dhe jo një punim individual i studentit. Në vitin akademik 2018-2019 janë diplomuar 52 studentë në këtë program studimi dhe provimi i diplomës është mbuluar nga personeli akademik me kohë të plotë.</p> <p>[RVB tab. 23.1, fq.125; Evidenca I.8: Ngarkesa Mësimore e Departamenti i Ekonomiksit, Evidenca përmbledhëse]</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Plani mësimor për këtë program studimi parashikon punë në laborator për lëndët informatikë, statistikë dhe ekonometri. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi që Njësia kryesore kishte angazhuar personel ndihmës mësimor për mirëmbajtjen e laboratorit dhe mbështetjen e studentëve gjatë realizimit të punëve praktike.</p> <p>[Evidenca II.8-Kapacitetet fizike dhe akademike]</p>			
Shkalla e përmbushjes	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

së standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Rektorati i UV ka miratuar udhëzuesin "Mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve" me vendimin nr.1, datë 13.01.2020. Dokumenti synon t'i vijë në ndihmë stafit akademik në procesin e mësimdhënies dhe në të përfshihen udhëzime mbi zhvillimin e metodave të mësimdhënies në bazë programi apo lënde duke marr në konsideratë rrethana të reja të ofrimit të shërbimit të edukimit në nivel institucional. <i>GVJ konstaton që ky është një instrument shumë i mirë që i vjen në ndihmë personelit akademik, sidomos atyre që kanë pak përvojë në mësimdhënie, por për të qënë më praktik në zbatim duhet të pasurohet me shembuj.</i> [Evidenca N-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Struktura përgjegjëse në nivel institucional për zhvillimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit është NJSBCVI, funksionet dhe detyrat e së cilës janë përcaktuar në Statutin e UV [Evidenca A. Statuti i UV, neni 82] . Për të realizuar vlerësimin periodik të personelit akademik dhe ndihmës akademik Njësia ka hartuar dy instrumenta: Pyetësoin e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve për çdo program studimi dhe pyetësoin e studentëve për vlerësimin e shërbimeve administrative. Me të dhënat që mbledhen nga këto instrumenta hartohen raporte ku analizohen të dhënat e pyetësorëve, jepen gjetjet, propozime dhe rekomandime. Gjetjet i përcillen paraprakisht personelit përmes Njësive kryesore, të cilat i diskutojnë dhe japin gjithashtu rekomandimet e tyre. Raporti dhe plani i masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë diskutohen në Rektorat

	<p>dhe i përcillen për miratim Senatit akademik.</p> <p>[Evidenca K- Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor per vitin akademik 2017-2018; Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor per vitin akademik 2018-2019]</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin AMS dhe nga takimet e zhvilluara në institucion konkludon që instrumentat e hartuara janë zbatuar nga NJSBCVI dhe procesi ka qënë gjithëpërfshirës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Pyetësi i miratuar nga Senati Akademik plotësohet nga studentët përmes llogarisë së tyre online në sistemin UVMS. Çdo student i rregullt ka të drejtën e plotësimit të pyetësorit në fund të semestrit vetëm për lëndët që ka frekuentuar. Përgjigjet ruhen dhe përpunohen në mënyrë anonime. Sipas evidencave rezultojnë që ka një pjesëmarrje të mirë të studentëve në këtë proces. Mbështetur në evidencat dhe informacionin e siguruar gjatë takimeve në institucion GVJ konstaton se IAL ka institucionalizuar, garantuar dhe dokumentuar përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik.</p> <p>[Evidenca K- Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017-2018; Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019; Evidencë Shënimet]</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBCVI si njësi përgjegjëse për sigurimin e cilësisë përgatit raporte me të dhënat e pyetësoreve. Raporti i përcillet paraprakisht personelit përmes Njësive kryesore dhe Njësive bazë, të cilët diskutojnë dhe japin mendimet e tyre në lidhje me gjetjet e raportit, si dhe rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Raporti dhe plani i masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë diskutohen në Rektorat dhe i përcillen për miratim Senatit Akademik. Rezultatet e vlerësimit përmes pyetësoreve bëhen publike në faqen e internetit të IAL-së.</p> <p>[Evidencë: Shënimet, Evidencë RVB fq. 34; Evidenca III.5-Kthim Përgjigje për raportin e analizës dhe vlerësimit të pyetësorit; https://univlora.edu.al/2019/12/11/publikimi-i-raportit-te-analizes-se-pyetesoreve-te-studenteve/]</p> <p><i>GVJ konstatoi që personeli akademik dhe ndihmës-akademik informohet me rezultatet e vlerësimit dhe ata mund të shprehin në lidhje me to përpara se raporti të miratohet nga Senati Akademik. Raportet e analizës së pyetësoreve publikohen në faqen e internetit të UV dhe janë lehtësisht të aksesueshme për studentët apo grupe të tjera interesi. GVJ rekomandon që gjetjet e vlerësimit dhe masat e planifikuara për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie mund të përfshihen në mënyrë të përmbledhur edhe në raportin vjetor ku trajtohen problematikat mbi sigurimin e</i></p>

	<i>brendshëm të cilësisë. Kjo do ta përmirësonte raportin.</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	Promovimi i praktikave të mira realizohet kryesisht në nivelin e njësisë bazë. Kjo realizohet në analizën vjetore të punës dhe gjatë procesit të vlerësimit të performancës për stafin akademik. UV për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor nxit dhe mbështet financiarisht pjesëmarrjen e pedagogëve në konferenca shkencore dhe publikimet e tyre në revista shkencore. Nga kjo mbështetje kanë përfituar dhe pedagogët e Departamentit të Ekonomiksit. [Evidenca IV.2-Përcjellja e propozimit të projekt buxhetit nga Fakulteti i Ekonomise; Evidenca I- Raporti vjetor i UV për vitin 2017-2018; Evidenca J- Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Referuar planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve GVJ konstaton që format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve për këtë PS janë leksionet dhe seminarët. Raporti midis leksioneve dhe seminarëve ndryshon sipas natyrës së lëndës. Në auditor realizohen gjithësej 1830 orë nga të cilat 68% e orëve janë leksione dhe 32% janë seminare. Format e mësimdhënies janë të reflektuara në syllabus. Detyra e kursit, esetë dhe projektet janë të përfshira në disa module si forma të kontrollit të vazhdueshëm. [Evidenca RVB tab.10, fq-115-116; Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset)]
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Referuar takimeve me stafin akademik dhe studentët GVJ konstatoi që personeli akademik përdor metoda alternative në mësimdhënie, duke mbajtur në konsideratë natyrën e lëndës dhe programin e studimit. Vitet e fundit i është dhënë rëndësi metodave audiovizive për të cilat është krijuar dhe infrastruktura e nevojshme. [Evidenca Shënimet] Një ndihmesë për departamentin kanë qënë opinionet e studentëve për procesin mësimor, përmes të cilave janë identifikuar problematikat dhe vështirësitë e tyre gjatë procesit të mësimnxënies. GVJ konstatoi që krahas leksioneve dhe seminarëve në disa lëndë përdoren dhe forma të tjera të mësimdhënies si leksionet e hapura, rastet studimore, detyrat e kursit për t'i përgjigjur më mirë nevojave të studentëve.

	[Evidenca III.12-Leksion i hapur]
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Përmirësimi i kompetencave didaktike të personelit akademik është mbështetur me hartimin e udhëzuesit "Mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve". Personeli akademik është përfshirë gjithashtu në programe të ndryshme shkëmbimi në universitete evropiane, të cilat kanë shërbyer për marrjen e përvojës dhe praktikave më të mira në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor. GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi që drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore i kanë ofruar gjithë mbështetjen e tyre personelit akademik për të përmirësuar kompetencat e tyre në fushën didaktike. [Evidenca III.6- Mobilitet stafi për tranim dhe mësimdhënie]
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	GVJ mbështetur në evidencat si CV, eksperiencia mësimdhënëse e stafit, fusha e tyre e studimeve të ciklit të tretë, veprimtaria kërkimore shkencore është i mendimit që stafi akademik i PS zotëron kompetencat e duhura të mësimdhënies. [Evidenca II.12-CV e stafit akademik dhe ndihmës për programin e studimit Bachelor në EkonomiksEvidenca II.14-Miratimi dhe përcjellja e Raportit Vjetor të Departamentit të Ekonomiksit] Gjithashtu 90% e studentëve në vlerësimin periodik janë shprehur që personeli akademik ka aftësi dhe kompetencat shumë të mira dhe të mira në mësimdhënie. GVJ e konfirmoi këtë opinion dhe gjatë vizitës në institucion në takimin me personelin akademik dhe studentët. [Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019; Evidencë Shënimet].
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ u njoh për përmbushjen e këtij kriteri përmes dokumentacionit të ngarkuar në AMS, si dhe takimeve me personelin akademik, NJSBCVI dhe studentët gjatë vizitës në IAL. GVJ konstatoi që personeli akademik është i angazhuar për të përmirësuar në mënyrë periodike metodat e mësimdhënies, si dhe për të përdorur metoda të reja. Mendimi i studentëve për efektivitetin e metodave të mësimdhënies tërhiqet në mënyrë të vazhdueshme përmes pyetësorve. Në funksion të përmirësimit të metodave të mësimdhënies UV ka siguruar infrastrukturën e nevojshme si kompjutera, projektorë në sallat etj.. UV ka miratuar gjithashtu një udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. [RVB, fq.37, Evidenca Shënimet; Evidenca N-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve]
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe	Për t'i bërë sa më tërheqëse orët e mësimi aplikohen metoda të




diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	ndryshme si diskutimi në orët e seminareve, zgjidhja dhe diskutimi i ushtrimeve në klasë, trajtimi në orët e mësimit i teorive dhe problemave shtesë, analiza e rasteve studimore. [Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset)]. Përpos punës së bërë në këtë drejtim personeli akademik mendon që ka hapësirë për ta përmirësuar punën, si dhe për të adresuar vrejttjet e studentëve. [Evidenca K-Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017; 2018Evidenca III.5-Kthim Përgjigje për raportin e analizës dhe vlerësimit të pyetësorit]			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit dhe inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Mbështetur në dokumentacion GVJ konstaton që në përgjithësi metodat e mësimit dhe format e vlerësimit për të gjitha lëndët inkurajojnë punën e pavarur të studentëve. Detyrat individuale dhe/ose në grup zbatohen në të gjitha lëndët. Për realizimin e tyre studentët marrin udhëzime në auditor, në takime të drejta për drejta me pedagogun ose përmes postës elektronike. [RVB, fq.38; Evidenca II.1-Programet e lëndëve]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Referuar evidencave dhe vizitës në IAL rezultoi që mësimi për këtë PS zhvillohet në godinën e Fakultetit të Ekonomisë, me një sipërfaqe të përgjithshme 2365m ² ose 2.7m ² /studentë. Mësimdhënia për këtë PS zhvillohet kryesisht në katin e dytë të godinës me një sipërfaqe të përgjithshme 420m ² ose në 7 salla me sipërfaqe të ndryshme (salla leksioni dhe seminaresh). Referuar numrit të studentëve të programit të studimit (141 studentë) sallat janë të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimor. Për lëndët me numër të madh studentësh të regjistruar përdoren dhe sallat e mëdha të katit të katërt. Gjatë vizitës në IAL GVJ pati mundësinë që të vizitoj ambjentet e mësimit dhe konstatoi që hapësirat janë të mjaftueshme, cilësore, të mirëmbajtura mirë dhe me kushte higjeno-sanitare të mira. [RVB, tabela 16; Evidenca III.7-Infrastruktura e Universitetit Ismail Qemali Vlorë_opt]
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe	Gjatë vizitës në mjediset e mësimit GVJ konstatoi që sallat ishin të pajisura me infrastrukturën bazë për zhvillimin e procesit

<p>të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>mësimor (tavolina, karrike), dërrasa të zeza ose white board për të bërë shënimet e nevojshme gjatë orës mësimore, rrjetin e nevojshëm për përdorimin e pajisjeve elektronike (projektorë dhe laptop). Ndërkohë GVJ konstatoi që pajisjet si laptopë dhe projektor që garantojnë një mësimdhënie më cilësore nuk ishin të instaluar në salla, por mund të silleshin nga pedagogët sipas nevojave.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Për nevoja të menaxhimit të informacionit, të të dhënave të studentëve dhe procesit të mësimdhënies Njësia kryesore dhe njësia bazë përdorin Sistemin e Menaxhimit të Informacionit mësimor (UVMS), si dhe adresat zyrtare të email-it për personelin akademik dhe studentët. Për të lehtësuar komunikimin në Godinën e Fakultetit të Ekonomisë është instaluar linja fikse e internetit dhe ofrohet shërbimi wifi. GVJ pati mundësi gjatë vizitës në institucion të shoh funksionalitetin e UVMS. Në këtë platformë realizohet përveç menaxhimit të informacionit dhe shkarkimi i materialeve mësimore të postuara nga pedagogët. Platforma ofron mjaft lehësira për personelin akademik dhe studentët.</p> <p>[RVB,tab.17; Evidenca III.9-Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjise së informacionit]</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse për të gjitha lëndët miratohet nga departamenti. Bazuar në evidence, GVJ mendon që literatura e përzgjedhur është e përshtatshme për të gjitha lëndët, në shumë module ajo është e përditësuar dhe garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme në përmbushje të objektivave të programit.</p> <p>[Evidenca II.1-Programet e lendeve (Syllabuset); Evidenca II.9-Miratimi dhe përcjellja e literaturës nga Departamenti i Ekonomiksit]</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Në funksion të programeve të studimit të FE biblioteka ka shtuar 142 tituj në fushën e Ekonomisë nga të cilat 99 tituj në shqip dhe 43 tituj në anglisht për periudhën 2016-2018. Në total janë shtuar 1365 vëllime në gjuhën shqipe dhe 68 vëllime në gjuhën angleze. GVJ vizitoi mjediset e bibliotekës dhe konstatoi që ajo është vendosur në një ambient të përshtatshëm me ajër dhe hapësira studimi të mjaftueshme. <i>GVJ gjatë vizitës në bibliotekë gjatë një verifikimi rastësor të titujve konstatoi që biblioteka i disponon titujt që përfshihen në literaturën e detyrueshme dhe ndihmëse, por në një numër të kufizuar kopjesh.</i></p> <p>[Evidenca III.10-Informacioni për bibliotekën; Evidenca IV.2-Përcjellja e propozimit të projekt buxhetit nga Fakulteti i Ekonomisë]. <i>GVJ sugjeron që Njësia kryesore duhet të bëjë kërkesa të vazhdueshme për rritjen e numrit të vëllimeve për</i></p>

	<i>literaturën bazë në bibliotekën e UV.</i>
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	UV shfrytëzon në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies bibliotekën on-line (U-library), mbështetur me fonde të MASR dhe ofruar nga RASH. Biblioteka siguron akses për personelin akademik dhe studentët, e cila përmban shumë tituj të përshtatshme për programin e studimit. Gjatë vizitës në IAL, GVJ nuk pati mundësi të identifikojë shkallën e përdorimit nga studentët të kësaj platforme. [Evidencë https://ulibrary.rash.al/manual.pdf].
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	FE ka një laborator informatike që i përgjigjet nevojave të disa lëndëve dhe të gjitha PS. Ky laborator përdoret nga studentët e Ekonomiksitkryesisht për module si Informatika, Statistika dhe Ekonometria. GVJ gjatë vizitës në laborator konstatoi që laboratori ishte i kompletuar jo vetëm me programet standarte por edhe specifike në funksion të lëndëve të veçanta si p.sh <i>SPSS</i> dhe <i>Financa 5</i> . Megjithatë GVJ nuk arriti të verifikojë se në çfarë mase shfrytëzohen këto kapacitete për realizimin e detyrave të kursit apo punimeve të diplomës nga ana e studentëve.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Personeli akademik mund të përdor në funksion të mësimdhënies platformën elektronike UVMS. Kjo platformë mundëson shkarkimin nga studentët të leksioneve të ndryshme në formatin .pdf nëse ato janë postuar nga pedagogu i lëndës. Personeli akademik mund të ngarkojë në sistem edhe detyra dhe të hedhë vlerësimin për çdo studentë. Gjatë vizitës në IAL GVJ u informua që personeli akademik e përdor këtë hapësirë për të postuar materiale në funksion të mësimdhënies. [Evidenca III.9-Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit_opt; Evidencë Shënimit]
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Platforma elektronike UVMS mundëson komunikimin e brendshëm. Personeli akademik dhe studentët kanë të gjithë llogari personale në këtë platformë. Studentët kanë mundësi që të aksesojnë në kohë reale të gjitha të dhënat për performancën e tyre akademike duke u futur në profilin e tyre. Gjithashtu ata mund të bëjnë regjistrimin në module, të shkarkojnë transkriptin, të shohin vlerësimet, të shohin dhe printojnë orarin e mësimëve, të plotësojnë pyetëtorin e studentëve, etj. Ndërsa personeli akademikë në profilin e tij ka ikona për mësimdhënien, e-learning, njoftime, etj. GVJ konstatoi që platforma UVMS shfrytëzohej për komunikim si nga personeli akademik ashtu dhe nga studentët. [Evidenca III.9-Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit_opt; Evidencë Shënimit]
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të	Rregullorja e PS sanksionon që personeli akademik që caktohet për udhëheqjen e diplomave të studentëve i orienton studentët në

diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	përzgjedhjen e temave të diplomave dhe i mbështetin ata për zhvillimin e tyre. GVJ nuk mund ta konfirmonte në takimin me studentët këtë kriter, pasi nuk kishte studentë që punonin për tema diplome. [Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bsc Ekonomiks, neni 3].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në nivel institucioni funksionon Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, e cila përbëhet nga tre sektorë. Pjesë përbërëse e kësaj drejtorie është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional, e cila mbështet dhe ndërvepron me KSBCI.[Evidenca A- Statuti i UV-së, neni 13]. Një nga funksionet kryesore të kësaj njësie është vlerësimi i mësimdhënies për çdo program studimi. Njësia ka organizuar në nivel institucional pyetësorët e studentëve, përpunimin dhe analizën e tyre, si dhe ka përgatitur raporte. GVJ pasi u njoh me raportet dhe nga vizita në IAL konstatoi që kjo njësi ka evidentuar problematikat në cilësinë e mësimdhënies dhe ka dhënë rekomandime, <i>por GVJ nuk konstatoi ndonjë ndryshim të madh në raportet e dy viteve akademike. GVJ rekomandon që NJSBCVI duhet të ndjekë në vijimësi zbatimimin e rekomandime nga Njësitë bazë dhe zbatimi i tyre duhet të reflektohet në raportin e veprimtarisë së kësaj njësie (si pjesë e raportit vjetor).</i> [Evidenca A- Statuti i UV-së, neni 13; Evidenca K- Raport mbi rezultatet e pyëtësorit studentor për vitin akademik 2017-2018; Evidenca L- Raport mbi rezultatet e pyëtësorit studentor për vitin akademik 2018-2019]
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Bazuar në RVB dhe rregulloret e institucionit, Njësia bazë përgjigjet për zbatimin e planit mësimor dhe për të siguruar ofrimin e shërbimit me cilësi dhe sipas standardeve kombëtare. Në këtë veprimtari ajo mbështetet nga njësia kryesore dhe institucioni për të patur të gjitha burimet që nevojiten për të siguruar cilësinë në mësimdhënie. Krijimi i NJSBCVI-së i shërben rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentëve mbi cilësinë e PS.

<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitet përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>UV ka krijuar Qendrën Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillimin Rajonal, ku një nga qëllimet e krijimit të kësaj qendre është mbështetja e metodave eksperimentale bashkëkohore. <i>GVJ konstaton që qendra aktualisht ka një veprimtari modeste në zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Qendra ka bërë përpjekje për të hartuar një udhëzues, por atij i mungojnë shembujt dhe mënyrat se si mund të zbatohet.</i></p> <p>[Evidenca N- Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Mbështetur në evidencat dhe vizitën në institucion GVJ konstatoi që trajnimi i personelit akademik në fushën e kërkimit realizohet kryesisht përmes pjesëmarrjes së personelit në projektet kërkimore, seminareve, pjesëmarrjes në konferenca shkencore. Personeli akademik është mbështetur dhe finaciarisht për tu bërë pjesë e këtyre aktiviteteve. GVJ nuk arriti të evidentojë se si këto aktivitete kanë çuar në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. <i>GVJ mendon që kualifikimi i vazhdueshëm mbështetur në nevojat duhet të jetë më sistematik dhe për këtë rekomandon që strategjia në këtë fushë të plotësohet me planin e aktiviteteve.</i></p> <p>[Evidenca III.6- Mobilitet stafi për tranim dhe mësimdhënie; Evidenca G- Strategjia për Trajnimin e vazhdueshëm të Kërkuesve të Rinj; Evidenca IV.2-Përcjellja e propozimit të projekt buxhetit nga Fakulteti i Ekonomisë]</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitet përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>UV nuk ka një njësi përgjegjëse që të organizoj punën për trajnimin e vazhdueshëm të stafit në fushën e mësimdhënies. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që trajnimi i stafit realizohet kryesisht përmes mobiliteteve në universitete perëndimore (p.sh. në kuadër të programit Erasmus+) si dhe përmes bashkëpunimit të personelit me përvojë me stafin e ri. <i>GVJ rekomandon që IAL duhet të këtë një qasje më sistemike në fushën e trajnimit për metodat e mësimdhënies duke shfrytëzuar kapacitetet humane dhe ekspertizën që ka si institucion.</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Ndër detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik sipas Statutit të UV është zbatimi i programeve/planeve mësimore, si dhe angazhimi për përmirësimin dhe zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies. Gjatë vizitës në IAL, GVJ konstatoi që personeli i ka të qarta përgjegjësitë e veta dhe është i angazhuar maksimalisht për përmbushjen e tyre.</p> <p>[Evidenca A- Statuti i UV-së, neni 45, pika 2; Evidenca Shënimet]</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës</p>	<p>GVJ në takimet me drejtuesit e Njesisë kryesore/njesisë bazë dhe</p>

akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	personelin akademik konstatoi që personeli akademik aplikon individualisht metoda të reja mësimdhënie për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të studentëve. <i>GVJ sugjeron që zbatimi i këtyre metodave të institucionalizohet, ato duhet të analizohen, dokumentohen dhe rezultatet e tyre të raportohen në mënyrë periodike.</i> [Evidenca Shënime].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5				
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Testimi i njohurive, dijeve dhe aftësive është parashikuar në rregulloren e universitetit, rregulloren e departamentit dhe rregulloren e PS. Format e vlerësimit janë pasqyruar gjithashtu në mënyrë të detajuar në çdo syllabus. Në pjesën më të madhe të lëndëve vlerësimi është i vazhdueshëm dhe përbëhet nga vlerësimi gjatë vitit, provimi i pjesshëm dhe provimi final. Provimet mund të zhvillohen kryesisht me shkrim, me gojë ose të kombinuara. [Evidenca I.2-Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit, kreu IV, neni 17; Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks, kreu III, neni 8; Evidenca C- Rregullore UV-së e ndryshuar, nenet 45, 61, 63 dhe 65;Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset)]			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion që titullarët e lëndëve informojnë në fillim të semestrit studentët mbi programin e lëndës, detyrimet dhe format alternative të vlerësimit mbështetur në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ mbështetur në rregulloret dhe programet e lëndëve konstatoi që në këtë PS përdoren forma të ndryshme vlerësimi si: vlerësimi gjatë vitit (detyrat dhe aktivizimi në klasë 10-15% të vlerësimit), provimi i pjesshëm (25-30%) dhe provimi final (60-70%). Format e vlerësimit janë të përshtatshme për këtë PS dhe i japin mundësi studentëve të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. [Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset)]			
Shkalla e përmbushjes	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

së standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Testimi dhe vlerësimi i studentëve realizohet në fund të semestrit kur zhvillohet lënda në datat e shpallura nga Njësia kryesore. Në rastet kur studenti nuk rezulton kalues ai riprovohet në sezone të tjera provimi. Rregulloret kanë parashikuar gjithashtu që Dekani i fakultetit mund të hapi sezone të posaçme duke ndjekur procedurat për provimet e lëndëve dhe provimin e diplomës. GVJ referuar evidencave dhe vizitës në institucion konstatoi që testimi dhe vlerësimi realizohet gjatë gjithë vitit akademik. [Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks, neni 8, pika f dhe k, neni 12 pika h dhe neni 14, pika j; Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset); Evidenca A- Statuti i UV-së, neni 67; Evidenca Shënimit]
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UV ka një platformë për menaxhimin e informacionit në fushën e mësimdhënies. Kjo platformë ka disa funksione, por nuk mundëson testimin dhe vlerësimin online. GVJ nga dokumentacioni dhe vizita në institucion konstatoi që vlerësimet e studentëve duhet të hidhen në sistem brenda 48 orëve. GVJ konkludoi që kufizimi në kohë i dhënies së vlerësimeve ndihmon në rritjen transparencën dhe minimizon mundësitë për abuzime. [Evidenca III.9-Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë s informacionit_opt]
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstatoi që testimi dhe vlerësimi përfundimtar është parashikuar në rregulloren e IAL dhe atë të PS mbështetur në evidencat e ngarkuara në AMS. Testimi dhe vlerësimi përfundimtar është realizuar nga komisione, në përbërje të të cilave kanë qënë jo më pak se dy antarë nga të cilët një ka qënë titullari i lëndës. Komisionet janë ngritur nga përgjegjësi i departamentit dhe miratuar nga Dekani. GVJ konstatoi që kjo procedurë zbatohet dhe është e dokumentuar. [Evidenca II.10-Kalendari i provimeve si dhe komisionet e provimeve; Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks, neni 10, pika d]
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të	Sipas rregullores së IAL testimi dhe vlerësimi i njohurive me shkrim nuk zhvillohet në mënyrë anonime. Pedagogët e lëndës janë përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit deri në shpalljen e rezultateve. Monitorimi i provimit bëhet nga personeli akademik, antarë të komisioneve të provimit. [Evidenca C- Rregullore UV-

monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	së e ndryshuar, neni 60-63]
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Sipas rregulloreve studentët kanë të drejtë të shohin provimin e korigjuar pas daljes së rezultateve. Kjo bëhet 24 orë pas daljes së rezultatit. Gjatë këtij ballafaqimi ata mund të shohin ku kanë gabuar, të njihen me zgjidhjen korrekte të tezës dhe nëse nuk bien dakort mund të kërkojnë rivlerësim apo të kërkojnë sqarime të mëtejshme nga përgjegjësi i departamenti. GVJ gjatë takimit me studentët konfirmoi që ata i marrin rezultatet e vlerësimit përmes platformës UVMS dhe e njohin procedurën e njohjes me rezultatet. [Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks, neni 8, pika j; Evidenca Shënimet]
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	GVJ mbështetur në evidenca konstatoi që institucioni ka parashikuar në të gjitha rregulloret dhe kodin e etikës masa për të shmangur kopjimin në provime dhe plagjaturën. Pedagogët e lëndës tërheqin vëmendjen e studentëve edhe përmes syllabuseve që nuk lejohet kopjimi i detyrave individuale, kopjimi në provim, mbajtja e telefonave celularë apo komuniqi në të gjitha format. <i>Megjithatë GVJ nuk arriti që të evidentonte ndonjë praktikë, se si personeli akademik e realizon në praktikë shmangien e plagjaturës.</i> [Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks, neni 8, pika d; Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset); Evidenca E- Kodi i Etikës, neni 8, pika 6 dhe 8, neni 9, pika 8 dhe 9]
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e provimeve duhet të hidhen në platformën UVMS jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i provimit. Ky është një rregull që është parashikuar në rregulloren e PS. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që kjo procedurë zbatohet nga personeli akademik. [Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks, neni 8, pika i; Evidenca C- Rregullore UV-së e ndryshuar, kreu VII, neni 61]
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Referuar dokumentacionit të ngarkuar në AMS dhe takimeve në institucion GVJ konstatoi që e drejta e studentëve për tu njohur me vlerësimin apo për të bërë kërkesë për rishikimin e vlerësimit është e garantuar nga rregulloret në fuqi. Institucioni ka përcaktuar afate, procedura dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre. [Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks, neni 8, pika j, neni 11; Evidenca C- Rregullore UV-së e ndryshuar, kreu VII, neni 61 dhe 62]
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.	E drejta e studentëve për të ankimuar vlerësimin përfundimtar është e parashikuar në rregulloren e IAL dhe atë të PS. Dekani pasi informohet nga drejtuesi i njësisë bazë ngre një komision për të verifikuar pretendimet e studentëve, i cili bën dhe vlerësimin

Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	përfundimtar. Procesi i ankimimit duhet të dokumentohet në çdo hap të tij sipas rregullores. <i>GVJ në takimet me studentët dhe personelin akademik u informua që kjo praktikë zbatohet, por nuk pa ndonjë procedurë të dokumentuar.</i> [Evidenca C- Rregullore UV-së e ndryshuar, kreu VII, neni 62; Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks, neni 11]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Plani mësimor për këtë program studimi ofron 29 lëndë dhe diplomën të ndara në katër tipe veprimtarish. Renditja e lëndëve është e përshtatshme për këtë PS, pasi mundëson dhe garanton aplikimin e dijeve të marra në lëndë të ndryshme. Kështu p.sh shumë lëndë që zhvillohen në vitin e parë i përgatisin studentët për të aplikuar këto njohuri në lëndët e vitit të dytë dhe të tretë. GVJ konstaton që plani mësimor garanton thellimin e njohurive dhe aftëson studentët për zbatimin e njohurive ekonomike në sektorë të caktuar. [RVB, tabela 9]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Plani mësimor përmban disa lëndë si Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në Ekonomi, Sisteme Informacioni në Ekonomi, Shkrim Akademik dhe Gjuhën e Huaj të cilat mundësojnë zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve. Plani mësimor ofron 5 gjuhë të huaja dhe studenti mund të zgjedh midis tyre. Mbështetur në evidenca GVJ konkludon që ky PS garanton zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve. [RVB, tabela 9]
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh mbi mënyrën se si titullarët e lëndëve përcjellin tek studentët informacionin mbi objektivat e lëndës, format e veprimtarisë dhe rezultatet që synohen të arrihen. Departamenti analizon veprimtarinë mësimore në tërësi, por jo për çdo lëndë në veçanti. <i>GVJ rekomandon që kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti të bëhen pjesë e kësaj analize.</i> [Evidenca II.14-Miratimi dhe përcjellja e Raportit Vjetor të Departamentit të Ekonomiksit]
Kriteri 4. Në përfundim të çdo	Referuar informacionit të grumbulluar gjatë vizitës në institucion

lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	në takimet me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi që në orën e fundit të semestrit të gjithë titullarët e lëndëve bëjnë një përmbledhje të lëndës, temave dhe koncepteve kryesore, adresojnë pyetjet e studentëve dhe japin orientime rreth provimit përfundimtar. [Evidenca Shënimit].
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Departamenti i Ekonomiksit ka krijuar një traditë të mirë në bashkëpunimin me personalitete të fushës së ekonomisë brenda dhe jashtë vendit. Në dy vitet e fundit departamenti ka zhvilluar orë të hapura me zv. Guvernatoren e Bankës së Shqipërisë "Mbi politikën monetare në RSH" dhe një leksion mbi "Aksesin në financim. Stimulimi i projekteve ekonomike rajonale dhe lokale" me një lektor të huaj nga Akademia Diplomatike e Brukselit. [Evidenca III.12-Leksion i hapur].
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Sipas dokumentacionit të ngarkuar në AMS dhe vizitave në institucion rezultojnë që veprimtaritë mësimore në të gjitha lëndët i përshtaten natyrës së tyre dhe synojnë angazhimin më të madh të studentëve brenda dhe jashtë orës së mësimin. Kështu për shembull detyrat dhe diskutimet në klasës, detyrat e kursit, provimet e pjesëshme mundësojnë aplikimin e njohurive të marra. Kjo evidentohet në disa module si Shkrimi Akademik, Statistika, Kontabiliteti, etj. [Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset)]
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Personeli akademik në bazë të natyrës së lëndës mbështet diskutimet dhe punën në grup. Pothuajse të gjitha lëndët kanë të përfshirë në format e vlerësimit diskutimin në klasë, ndërsa disa lëndë kanë detyrat e kursit të cilat diskutohen në orën e seminarit. [Evidenca II.1-Programet e lëndëve (Syllabuset)].
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Puna e pavarur e studentëve dhe idetë e tyre kanë patur mbështetjen e personelit akademik në UV. Në vitin 2017 është organizuar një konferencë studentore, e cila ndër të tjera synonte të nxiste përfshirjen e studentëve në punën kërkimore. Në takimin me personelin akademik GVJ mori informacionin që studentët janë aktivizuar nga departamenti në projekte kërkimore. Pavarësisht klimës së përshtatshme që ekziston në nivel institucional, <i>GVJ konstaton që në tre vitet e fundit nuk ka patur përfshirje të studentëve në veprimtarinë kërkimore të njësisë bazë.</i> [https://univlora.edu.al/2017/12/15/konferenca_studentore-e-hapur-2017/].
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet	Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që në nivel institucional ka vullnet për të mbështetur idetë dhe projektet e studentëve. Struktura përgjegjëse për përcjelljen e kërkesave për financim në Bordin e Administrimit është Këshilli Studentor, i

financiarisht studentët.	cili sipas RVB është krijuar rishtazi dhe për rrjedhojë në vitet e fundit nuk ka patur mbështetje financiare për projektet e studentëve.[Evidenca Shënimet]			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Plani mësimor për këtë program studimi është hartuar mbështetur në eksperiencat e programeve të ngjashme në vendet të BE dhe universitetet me të cilat fakulteti ka bashkëpunuar në vite. FE ofron 7 module në gjuhën angleze për studentët e ciklit Bachelor. Këto elemente mundësojnë rritjen e mobiliteteve të studentëve të UV në kuadër të programit Erasmus+. <i>Referuar evidencave GVJ konstatoi që studentët vendas dhe të huaj nuk e kanë shfytëzuar këtë mundësi.</i> [Evidenca J- Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019, fq. 135; https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/SHQIP-Katalogy-i-1%C3%ABndC3%ABve-2019-2020.pdf].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Procedura e provimit final dhe diplomimit është përcaktuar në rregulloren e programit të studimit dhe procedurat e diplomimit të departamentit. Studentët i përmbyllin studimet me provim final, për të cilin departamenti ka hartuar një procedurë të plotë (bankën e pyetjeve, tezat e provimit, etj.). GVJ konkludon që kjo procedurë është e qartë, e përshtatshme për PS dhe studentët janë të informuar për detyrimet që duhet të plotësojnë përpara diplomimit. [Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks, neni 3, 14; Evidenca III.13-Procedura e diplomimit në Departamentin e Ekonomiksit]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Personeli akademik dhe sekretaria mësimore vendos në dispozicion të studentëve të gjitha udhëzimet dhe materialet e nevojshme për provimin final. Komisioni ad-hoc i ngritur nga departamenti verifikon transkriptet e studentëve përpara diplomimit dhe e përcjell informacionin në dekanat. Gjatë vizitës në IAL GVJ konstatoi që personeli akademik dhe sekretaria mësimore asistojnë studentët dhe vënë në dispozicion të tyre të gjitha materialet në funksion të provimit final. Sipas rregullores së PS banka e pyetjeve iu vihet në dispozicion studentëve të paktën 2 muaj përpara provimit të diplomimit. [Evidenca III.13-Procedura e diplomimit në Departamentin e

	Ekonomiksit;Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor ne Ekonomiks, neni 15]
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Personeli akademik ka hartuar bankën e pyetjeve (120 pyetje=12 lëndë me 10 pyetje secila), e cila iu bëhet e njohur studentëve përpara diplomimit. Banka e pyetjeve është krijuar kryesisht nga lëndë karakterizuese të cilat zhvillohen në të tri vitet akademike. Pyetjet sipas lëndëve kontrollojnë njohuritë kryesore të marra në këto lëndë dhe është mbajtur në konsideratë ndërthurja e njohurive midis lëndëve. Tezat e provimit të diplomimit janë hartuar mbështetur në bankën e pyetjeve. GVJ mendon që kjo mënyrë e realizimit të provimit final është e përshtatshme për këtë PS. [Evidenca III.13-Procedura e diplomimit në Departamentin e Ekonomiksit]
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Referuar dokumentacionit të PS dhe takimeve në IAL, GVJ konkludon që studentët ndihmohen për përgatitjen e provimit final. Personeli akademik iu përgjigjet nevojave të studentëve me takimet të drejtëpërdrejta ose përmes postës elektronike. Në tre vitet e fundit akademike studentët kanë shlyer diplomën vetëm me provim final, për arsye të mospërbushjes së kriterit të notës mesatare. [Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks, neni 15]
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Referuar dokumentacionit dhe takimeve në IAL, Departamenti Ekonomiksit ka kapacitete për të mbështetur studentët për të grumbulluar dhe interpretuar të dhëna për fusha të ndryshme të ekonomisë, por në tre vitet e fundit kjo nuk ka qënë e nevojshme për ciklin e parë pasi studentët janë diplomuar vetëm me provim final.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Referuar dokumentacionit dhe takimeve në IAL, GVJ gjykon që personeli akademik i departamentit të ekonomiksit ka kapacitetet, aftësitë dhe përkushtimin për të asistuar dhe ndihmuar studentët për përgatitjen e temave të diplomave. GVJ nuk mund të merrte informacion për zbatimin konkret të këtij kriteri pasi në tre vitet e fundit akademike nuk ka patur studentë që kanë bërë punim diplome.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Procedura e provimit të diplomimit (diplomë ose provim) është përcaktuar në rregulloren e programit të studimit. Mbështetur në dokumentacion, GVJ konstatoi që kjo procedurë është zbatuar në mënyrë korrekte nga Departamenti dhe në përfundim të diplomimit studentët vlerësohen me notë. Vlerësimi bëhet nga të gjithë antarët e komisionit të diplomimit. [Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks,

	neni 15; Evidenca III.13-Procedura e diplomimit në Departamentin e Ekonomiksit]			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Pajisja e studentëve me diplomë është përcaktuar në rregulloren e IAL dhe rregulloren e PS. Pas përfundimit të studimeve dhe shlyerjes së të gjitha detyrimeve studenti pajiset me diplomën, listën e notave dhe suplementin e diplomës. GVJ mbështetur në dokumentacion konstatoi që studentët pajisen me këto dokumenta sipas legjislacionit në fuqi. [Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks, neni 16; Evidenca II.4-Model Diplome dhe Suplementi Bachelor në Ekonomiks]			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Sipas RVB kopja e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar i vihet në dispozicion studentit vetëm me kërkesën e tij pasi është diplomuar. <i>GVJ nuk gjeti ndonjë referencë në rregulloren e PS në lidhje me këtë kriter.</i> [Evidenca I.5-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Ekonomiks]			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	UV ruan në formë të shkruar të dhënat e studentëve duke mbajtur tre regjistra: regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Sipas statutit regjistrat ruhen për të gjithë periudhën e ekzistencës së IAL. Regjistri i arritjeve akademike dhe regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave ruhen dhe në formë elektronike. Në sekretarinë mësimore ruhen gjithashtu dosjet individuale të studentëve, mbi bazën e të cilave bëhet regjistrimi dhe matrikulimi i studentëve. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve bëhet nga Sekretaria Mësimore në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konstatoi që dokumentacioni ruhet konform ligjit dhe rregulloreve në fuqi. [Evidenca A- Statuti i UV-së, neni 78-79; Evidencë Shënimit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Të dhënat e personelit akademik mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo Zyrë është përgjegjëse për të mbledhur dokumentacionin dhe për të ndjekur procedurat sipas ligjit dhe rregulloreve të brendshme të institucionit në lidhje me rekrutimin e stafit të ri akademik. E njëjta Zyrë është përgjegjëse për të përditësuar dokumentacionin e stafit ekzistues akademik dhe për të ndjekur procedurat ligjore në lidhje me marrëdhënien kontraktuale të tyre me institucionin. GVJ kontrolloi në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik dhe ndihmës akademik dhe vërejti se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit. [Evidenca A Statuti i UV, Evidenca IV.I Procedura e punësimit të personelit]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka procedura për rekrutimin e personelit akademik të cilat janë të reflektuara në Statutin e Universitetit neni 51 dhe sipas ligjit nr.80/2015, neni 64 dhe të cilat ndiqen në mënyrë rigorozë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Departamentin e Ekonomiksit. [Evidenca IV.I Procedura e punësimit të personelit]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritereve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore ndjek përmbushjen e kritereve ligjore dhe specifike. Kriteret specifike vendosen nga Njësia bazë, që është Departamenti i Ekonomiksit dhe i referohen fushave si mesatarja e studimeve, fusha e studimit, ciklet e studimit, eksperiencës në mësimdhënie, publikimet, trajnimet etj. Ekziston një pikëzim për kriteret: në bazë të mesatares dhe kritereve specifike, ku plotësimi i dosjes ka 90% të totalit të pikëve dhe intervista 10%. Të gjitha pozicionet e hapura publikohen në web faqen e Universitetit. [Evidenca IV.I Procedura e punësimit të personelit, Evidenca Informacion për GVJ]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat e rekrutimit të personelit akademik, kriteret e përgjithshme dhe specifike hartohen nga Departamenti i Ekonomiksit dhe bëhen publike në web faqen e Universitetit. Institucioni, për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, ndan kriteret për vlerësimet e kandidatëve për staf akademik në:</p> <ul style="list-style-type: none"> A. Kriteret të përgjithshme: të cilat i referohen ligjit B. Kriteret specifike: të cilat i referohen kompetencave C. Intervistë me gojë <p>Nga këto, pikat A dhe B kane 90% të peshës së vlerësimit dhe</p>




	pika C 10%. [Evidenca IV.I Procedura e punësimit të personeli]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Infrastruktura e UV e pajisur me tre godina krijon kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Personeli akademik ka zyra të veçanta dhe po ashtu edhe zyra mbledhjesh dhe takimesh.</p> <p>Godina A e insitucionit, ku ndodhet edhe Departamenti i Ekonomiksit disponon salla leksionesh, auditorë për seminarë, sallë kompjuteri dhe laborator, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme mësimore, të konfirmuara edhe gjatë vizitës se GVJ.</p> <p>Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, Biblioteka, etj janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre.</p> <p>[Evidenca III.7 Infrastruktura e UV]</p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Programi i studimit mbulohet nga njësia bazë që është Departamenti i Ekonomiksit. Ky Departament përbëhet nga 7 anëtarë PAE dhe 2 PAK, 1me titull profesor, 6 doktor shkencash dhe 2 në proces doktore. Strategjia e Departamentit të Ekonomiksit parashikon plotësimin e misionit të tij nëpërmjet “sigurimit të një karriere të sukseshme për studentët dhe për stafin e tij akademik” (fq.8 Strategjia e Departamentit). Në funksion të kësaj institucioni ka krijuar hapësira për përfshirjen e stafit në programet e mobilitetit Erasmus dhe në programet Horizon 2020 të Komunitetit Evropian. Po ashtu ka parashikuar në projekt propozimin e buxhetit të vet mbështetje financiare për stafin që merr pjesë në konferenca dhe boton artikuj shkencorë.</p> <p>GVJ në takimin e kryer me personelin akademik u bë me dije edhe nga akademikët për mbështetjen financiare për konferenca dhe botime, siç parashikohet nga buxheti. Ky fond është shfrytëzuar plotësisht sipas konfirmimit të stafit akademik. Procesi i aplikimit kalon hallkat e miratimit të përgjegjësit të</p>

	<p>Departamentit, të Dekanit dhe të Bordit të Administrimit.</p> <p>[Evidenca G- Strategjia për Trajnimin e vazhdueshëm të Kërkuesve të Rinj;Evidenca III.6- Mobilitet stafi per tranim dhe mesimdhënie, IV.2: Evidenca IV.2-Përcjellja e propozimit të projekt buxhetit nga Fakulteti i Ekonomisë]</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Siç përmendet edhe në RVB, por edhe nga vërtetimi i GVJ në takimin me stafin akademik, institucioni <i>nuk ka organizuar programe specifike për të kualifikuar më tej stafin e tij</i>. Kryesisht stafi i ka marrë këto lloj trajnimesh ose njohje me këto metoda gjatë mobiliteteve në universitete të tjera. Vlen të theksohet se UV ka fituar çmimin si promovuesi më i mirë për programet e mobiliteteve Erasmus dhe parashikon në qershor 2020 të kryejë një trajnim për përdorimin e këtyre mobiliteteve. Po ashtu referuar RVB është marë një iniciativë nga Rektorati me vendim nr.1 dt 13.01.2020 për zhvillimin dhe përdorimin e metodave innovative të <i>mësimdhënies, por nuk ka një aplikim konkret të këtij vendimi</i>.</p> <p>[Evidenca N, Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave te ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në baze tëfushës së studimeve, moduleve]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Sipas ligjeve në fuqi Departamenti i Ekonomiksit planifikon kohën vjetore të punës sipas realizimit të procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe transferimit të dijeve. Sipas evidencave të dorëzuara për ngarkesën e stafit akademik për vitin 2019-2020, stafi i angazhuar në programin e Ekonomiksit mbulon orë mësimore në auditor që variojnë nga minimum 220 orë mësimore në maksimumin 465 orë mësimore për stafin PAE. <i>GVJ gjykon që kjo ngarkesë është e lartë dhe mund të ndikojë negativisht në cilësinë e mësimdhënies</i>.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Standardi IV.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në</p>	<p>Universiteti i Vlorës e përmbush këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike dhe praktike në përputhje me natyrën specifike të programit të</p>

<p>varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>studimit dhe moduleve përkatëse. Godina A, ku gjendet edhe Fakulteti Ekonomik dhe Departamenti i Ekonomiksit zhvillon mësimdhënien e programeve të veta ka hapësira të mjaftueshme për numrin e studentëve (141 në të tre vitet) që ka aktualisht. Godinat përdoren në dy fasha orare. [Evidenca RVB, tab.16; Evidenca III.7-Infrastruktura e Universitetit]</p> <p>GVJ vizitoi mjediset e godinës dhe vërtetoi se ato plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral dhe ishin të pajisura me sistem ngrohje. Biblioteka po ashtu ishte në një ambient të përshtatshëm me ajër dhe hapësira studimi të mjaftueshme. Laboratori i Ekonomiksit ishte i pajisur me programe soft që përdoren në mësimdhënien e moduleve specifike si Kontabiliteti Financiar apo Ekonometria.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Klasat e godines A siç GVJ vërtetoi në vizitën e tij ishin të pajisura me tabela whiteboard dhe videoprojektor të lëvizshëm, të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore, <i>por jo me pajisje kompjuterike stabël që të garantonin procesin mësimor nëpërmjet prezantimeve në powerpoint. Videoprojektori i lëvizshëm nevojitej të kishte laptop pedagogu.</i></p> <p>Laboratori i Departamentit të Ekonomiksit, i cili ishtenë funksion të zbatimit të këtij programi studimi, ishte i kompletuar jo vetem me programet standarte por edhe specifike si p.sh <i>Financa 5 dhe SPSS</i> në funksione të lëndëve të veçanta si Kontabiliteti apo Statistika.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratori i Departamentit të Ekonomiksit, i cili ishtenë funksion të zbatimit të këtij programi studimi, ishte i kompletuar jo vetëm me programet standarte por edhe specifike si p.sh <i>Financa 5 dhe SPSS</i> në funksion të lëndëve të veçanta si kontabiliteti apo statistika. GVJ kreu inspektim në vend dhe verifikoi programet specifike të instaluar në kompjutera. Laboratori kishte 25 vende, të cilat konsiderohen të mjaftueshme për numrin e studentëve në programin e Ekonomiksit.</p> <p><i>Por në takimin që pati me studentët GVJ konstatoi se ata nuk i kanë përdorur këto programe soft për kryerjen e detyrave të tyre.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>[Evidenca Shënime]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, referuar RVB-së por edhe vizitës në institucion, GVJ shprehet se ky kriter nuk aplikohet për programin në fjalë.</p>

mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni disponon 3 biblioteka të shfrytëzueshme nga studentët e programit të studimit. GVJ vizitoi bibliotekën Qëndrore që i shërben Departamentit të Ekonomiksit dhe programit të studimit Bachelor në “Ekonomiks”. Ambjenti ishte i hapur me ajër dhe ndriçim natyral, me vendosje të tavolinave në mënyrë që shfrytëzimi i tyre të bëhet në mënyrë të barabartë nga studentët. Orari i bibliotekës ishte 08:00 – 20:00. Frekuentimi i bibliotekës arkivohej në kartela të veçanta të cilat prodhonin një formë raporti se sa studentë e frekuentonin bibliotekën gjatë çdo viti akademik. Nga personeli i bibliotekës u konfirmua se studentët e frekuentonin bibliotekën kryesisht gjatë periudhave të provimeve, ose në rastin që kishin për të përgatitur projekte dhe duhet të rishikonin literaturë.[Evidenca III.10- Informacioni për bibliotekën; Evidenca Shënimet]
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Referuar RVB-së dhe evidencave, të gjitha bibliotekat e UV kanë rreth 15000 tituj me 35000 kopje në gjuhën shqip dhe anglisht. Gjate vitit 2016-2018në fushën e Ekonomisëjanë shtuar 140 tituj, nga të cilat 33 tituj në anglisht. Në total fondi i bibliotekës është shtuar me 1433 vëllime në fushën e Ekonomisë, nga të cilat 68 në gjuhën angleze. Në kontrollin rastësor që GVJ kreu për dy tituj, një në anglisht dhe një në shqip, të paraqitura si literaturë e detyrueshme në syllabuset e programit Bachelor në “Ekonomiks” konstatoi se biblioteka I dispononte të dyja, në 5 kopje librin në shqip dhe një kopje librin anglisht. Numri i kopjeve për titujt e teksteve mësimore të futura rishtazi në bibliotekë luhet nga 5-30 kopje. Ndër titujt e rinj ka dhe disa tekste që janë përkthime të teksteve nga gjuha




	<p>angleze.Për disa lëndëka më shumë se një titull që është në dispozicion të studentëve.[Evidenca III.10-Informacioni për bibliotekën; Evidenca Shënimet]</p> <p><i>GVJ konkludoi që UVka rritur në vitet e fundit fondin e bibliotekës meliteraturën e detyruar dhe ndihmëse dhe sugjeron që të vazhdojë të shtojë numrin e kopjeve fizike për literaturën në shqip, dhe/ose të kopjeve elektronike për literaturën në gjuhë të huaj, në mënyrë që studentët të kenë aksesin e nevojshëm.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga webfaqja e universitetit GVJ vërteton se UV krijon kushte për akses pa pagesë tek biblioteka online, pjesë e rrjetit ndërkombëtar Cobis.net. UV është në bashkëpunim me Bibliotekën e Akademisë së Shkencave në unifikimin e bibliotekave universitare. Gjithashtu UV ka akses për personelin akademik dhe studentët në librarinë digjitale të ofruar nga RASH dhe financuar nga MASR</p> <p>[https://ulibrary.rash.al/]</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Aktualisht biblioteka ka pajisje elektronike dhe akses në internet,e cila iu mundëson studentëve shfrytëzimin e fondeve të bibliotekës online.Digjitalizimi dhe radhitja e fondit është në proces. Studentët duhet të drejtohen tek punonjësi përkatës për librat që ju nevojiten.GVJ rekomandon që të instalohetnjë program kompjuterike, i cili do t'iu vinte në ndihmë studentëve për të kërkuar në fondin e bibliotekës dhe do të mundësonte një shfrytëzim më të mirë të tij.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>UV bën përpjekje për shtimin e zërave të bibliotekës, duke përfshirë në buxhetin vjetor të çdo Departamenti/Njësie kryesore nevojat për pasurimin e literaturës. Sipas informacionit të bibliotekës rezulton që në periudhën 2016-2019 janë realizuar dy blerje të cilat kanë pasuruar dhe rifreskuar fondet e bibliotekës. Kërkesat e Fakulteti i Ekonomisë kanë qënë të përfshira në të dyja blerjet. <i>GVJ gjykon se kjo praktikë duhet të vazhdojë, pasi mundëson jo vetëm pasurimin e fondeve por dhe përditësimin e literaturës që i kanë kaluar afatet ligjore.</i></p> <p>[Evidenca III.10-Informacioni për bibliotekën]</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka i vihet në dispozicion studentëve gjate orareve publike e Hënë–e Premte nga ora 8.00-20.00. Ky orar është përcaktuar me qëllim që studentët të kenë mundësi ta shfrytëzojnë atë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, si dhe për të përballuar numrin e studentëve të interesuar me kapacitetin e bibliotekës.</p> <p>[Evidenca III.10-Informacioni për bibliotekën]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka zyra mbështetëse të cilat mundësojnë administrimin dhe shpërndarjen e informacionit dhe respektojnë njëkohësisht konfidencialitetin për çështje të caktuara të tilla si Sekretaria Mësimore, Zyra e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe IT, Drejtoria e Edukimit: Kurrikula dhe shërbimi ndaj studentëve dhe Zyra e Karrieres, Alumni. UV gjithashtu disponon në zbatim të ligjit Rregjistrin Themeltar të Studentëve, Rregjistrin e arritjeve akademike dhe Rregjistrin e lëshimit të Diplomave dhe certifikatave. GVJ konstatoi mbajtjen e këtyre rregjistrave nga Sekretaria e Fakultetit.</p> <p>Në mbështetje të menaxhimit të informacionit, GVJ u bë me dije nga përfaqësues i IT së Universitetit për sistemin kompjuterik, të quajtur UMVS, që ata përdornin dhe funksionalitetet e tij në shërbim të studentëve, pedagogëve dhe stafit administrativ. Në vijim GVJ kërkoi një shikim më të detajuar për funksionalitetin e platformës, në të treja hallkat: administratë, student, pedagog, gjë e cila u plotësua në terren. Përdoruesit e këtij sistemi në të tre hallkat pajiseshin me kod dhe fjalëkalim që në fillim të marrëdhënies së tyre me UV. Kjo shërbente për t'u loguar në sistem në çdo kohë e për të marrë informacion të shpejtë e transparent.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nëpërmjet UMVS studenti kryen rregjistrimin e lëndëve, merr informacionin e lëndës nga pedagogu, ka akses tek lista e notave dhe merr çdo lloj lajmërimi nga çdo zyrë administrative e Fakultetit. Pedagogu nëpërmjet këtij sistemi komunikon me studentin në lidhje me lëndën dhe materialet e saj, si dhe me administratën në lidhje me hedhjen e notave. Administrata komunikon me të dyja palët studentë e pedagogë për zhvillime apo njoftime të llojeve të ndryshme. Në të gjitha pikëpamjet GVJ mendon se ky kriter plotësohet dhe se ky sistem i brendshëm menaxhimi dhe administrimi i informacionit kryhet në formën e duhur. <i>GVJ sugjeron zhvillimin e mëtejshëm të sistemit për të shërbyer edhe si një platformë mësimdhënie online, pasi siç na u bë me dije kjo kishte kufizim për shkak të kapacitetit arkivues.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë</p>	<p>UV siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Çdo përdorues</p>




personelin dhe studentët e programit të studimit.	ka kodin dhe fjalëkalimin e tij në sistemin informatik UMVS. [Evidenca III.9-Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit_opt]			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sistemi aktual ka një platformë elektronike, e cila lehtëson komunikimin interaktiv dhe mundëson shkëmbimin e informacionit midis pedagogeve dhe studenteve në kohe reale. Por ky informacion nuk mbahet përgjatë gjithë kohës pasi nuk ka kapacitete memorie të mjaftueshme. [Evidenca III.9-Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit_opt]			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Për të gjithë përdoruesit e tij, sistemi i menaxhimit UVMS siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik, administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale me ta.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja e internetit të UV paraqet në mënyrë të strukturuar informacionin për studentët, fakultetet dhe shërbimet për studentët në shqip dhe anglisht. [https://univlora.edu.al/]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni harton në mënyrë agregate një Raport Financiar, pjesë e raportit vjetor dhe buxhetit të miratuar për UV. Fakulteti i Ekonomisë në veçanti harton një plan buxhet me zërat respektiv për mbulimin e të gjithë programeve. Nuk ka një raport specifik për programin e studimit Bachelor në “Ekonomiks” në veçanti, por një raport të kostos mesatare të studentit në nivel institucioni. [Evidenca IV.2 Përcjellja e projekt buxhetit nga Fakulteti i Ekonomisë; Evidenca IV.4 Të dhëna për kostot e programit të studimit]

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Projekt buxheti i përbashkët për të gjitha programet e studimit që Fakulteti përcjell përfshin një pjesë të veçantë që i referohet Departamentit të Ekonomiksit dhe i cili përmban numrin e studentëve të rregjistruar në çdo cikël studimi, numrin e pedagogëve dhe ngarkesën e tyre mësimore për vitin akademik dhe orët shtesë, shpenzime korente, kosto trajnimi dhe seminare, udhëtime brenda dhe jashtë vendit, shpenzime për kërkimin shkencor dhe shpenzime kapitale.</p> <p>[Evidenca IV.2 Përcjellja e projekt buxhetit nga Fakulteti ë Ekonomisë]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifata e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Duke ju referuar RVB, institucioni i nënshtrohet auditimit financiar të jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe MASR. <i>Duke ju referuar RVB-së po ashtu, në organigramë ka një Njësi Auditimi të Brendshme që prodhon raporte analitike financiare por institucioni nuk ka vënë në dispozicion ndonjë prej tyre.</i> Dokumentacioni i vënë në dispozicion përmban akt-rakordime financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të nënshkruara nga Drejtoria e Financës dhe Thesarit. <i>GVJ nuk konstatoi një raport auditimi të mirëfilltë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Raportet financiare të prodhuara nga institucioni janë në formatin e akt-rakordimeve në nivel institucional, situacion shpenzimesh analitike dhe të dhëna progresive që përfshijnë të ardhurat faktike dhe planin. Të dhënat janë për periudha të ndryshme dhe në trajtën krahasimore të tri viteve.</p> <p>Në raportin vjetor të UV ka një pjesë të raportit financiar për vitin korent dhe paraardhes ku edhe paraqitet një analizë e përgjithshme mbi të ardhurat dhe shpenzimet, realizimi i buxhetit, identifikimi i investimeve dhe plan buxheti për vitin pasardhës.</p> <p>[Evidenca I- Raporti vjetor i UV për vitin 2017-2018; Evidenca J- Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të</p>	<p>UV financohet nga fondet e veta dhe fondet e akorduara nga MASR. Në raportin vjetor të UV paraqitet një analizë e përgjithshme mbi të ardhurat dhe shpenzimet, realizimi i buxhetit, identifikimi i investimeve dhe plan buxheit për vitin pasardhës të cilat garantojnë qëndrueshmërinë financiare të institucionit.</p> <p>[Evidenca J- Raporti vjetor i UV për vitin 2018-2019]</p>

domosdoshme në të ardhmen.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi, UV ka hartuar rregulloren e UV, rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, rregulloren e Departamentit të Ekonomikut, rregulloren e programit të studimit dhe Procedurat e Pranimit në ciklin e parë të studimit Bachelor në “Ekonomiks”. Këto rregullore dhe procedura përcaktojnë dhe specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. [Evidenca C: Rregullorja e UV, neni 39; Evidenca I.2 Rregullorja e Departamentit të Ekonomikut, kreu IV; Evidenca I.5 Rregullorja e Programi të ciklit të parë të studimit Bachelor në Ekonomiks, nenet 3 – 17]
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion dheshqyrtimi i Rregullores së Programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Ekonomiks”, GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat që ndjek UV nga hyrja në daljen e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Specifikisht të drejtat e studentëve paraqiten në kreun IV të Rregullores në fjalë. [Evidenca I.5 Rregullorja e Programi të ciklit të parë të studimit Bachelor në Ekonomiks; Evidenca II.6 Procedurat e pranimit]
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose	Kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes se studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e UV, të Departamentit të Ekonomikut dhe të programit të studimit. Në

<p>të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>këtë program studimi ka patur edhe largime edhe transferime studentësh. Nga takimi me Drejtorinë e Edukimit: Kurrikulës dhe Shërbimit ndaj Studenteve dhe Zyrën e Karrieres dhe Alumni u konfirmua që institucioni përdorte ditët e karrierës për të bërë publike procedurat dhe kriteret e pranimit, fushata informimi nëpërmjet grupeve të punës që përfshijnë pedagogë dhe studentë, open days dhe panairët e punës. Sipas RVB, politikat dhe procedurat bëhen publike përmes faqes së internetit të UV por në konstatimin e kryer në këtë webfaqe kishte informacion për rregulloren e Universitetit, jo për programin specifik.</p> <p>[Evidenca I.5 Rregullorja e Programi të ciklit të parë të studimit Bachelor në Ekonomiks, Evidenca II.6 Procedurat e pranimit; Evidenca II.7 Procedurat e transferimit]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Bazuar në legjislacionin në fuqi, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga vizita në institucion, GVJ konfirmon se procedura e pranimit të studentëve fillon me propozimin e kuotave nga Departamenti i Ekonomiksit, në Dekanat, e mandej me vendim Senati, urdhërohet nga Rektori të fillojnë procedurat e pranimit sipas kriterëve që ka vendosur çdo Departament, ku nëpërmjet një Komisioni të ngritur shqyrtohen aplikimet e studentëve. Shqyrtimi i aplikimeve vijon me një pikëzim të tyre, i cili dërgohet në Dekanat për miratim dhe publikohet për çdo raund aplikimesh. Në vijim të pranuarit që rregjistrohen dërgohen sërish për informacion në Dekanat, deri në përmbushjen e kuotave të caktuara.</p> <p>[Evidenca II.6 Procedurat e pranimit]</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme të pranimit të studentëve të përcaktuara në rregulloret përkatëse dhe ato specifike të miratuara në fillim të çdo viti, hartohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë së arsimit.</p> <p>Sipas nenit 4 të Rregullores së programit të studimit pranimiti i studentëve në programin e studimit të ciklit të parë bachelor në Ekonomiks kryhet sipas ligjit nr 80/2015, neni 74 dhe Rregullores se UV, neni 39. Sipas procedurës së pranimit Departamenti propozon kuota për kategori të veçanta, përfshirë edhe studentë të huaj. Për vitin akademik 2019-2020, propozimi i kuotave për programin specifik është ndarë në 80 kandidatë brenda vendit, 1 nga trojet, 1 shtetas i huaj, 1 me aftësi të kufizuara, 2 nga kategoria jetim, 1 me origjinë ballkano-egjiptiane, 5 transferime dhe 2 si program i dytë studimi.</p> <p>[Evidenca C Rregullorja e UV, neni 39, Evidenca I.5 Rregullorja e Programi të ciklit të parë të studimit Bachelor në Ekonomiks, neni 4, Evidenca II.6 Procedurat e pranimit]</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni</p>	<p>Udhëzimi i publikut në lidhje me procedurat dhe kriteret e</p>

udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	pranimit kryhet nga institucioni nëpërmjet diteve të karrierës, fushatave të informimit nëpërmjet grupeve të punës që përfshijnë pedagogë dhe studentë, open days dhe panairt e punës, siç GVJ konfirmoi nga vizita dhe takimi me zyrën përgjegjëse. Paralelisht përdorimi i mediave sociale dhe webfaqes ndihmojnë në këtë promovim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e UV, të Departamentit të Ekonomiksit dhe rregulloren e programit të studimit. Këto rregullore u vihen në dispozicion studentëve ditët e orientimit nga Përgjegjësi i Departamentit dhe anëtarë të tjerë të Departamentit. Përpos kësaj nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit dhe aksesit që studentit i jepet atje çdo informacion lidhur me rregulloret ju bëhet me dije që në fillim. GVJ e konstatoi këtë edhe nga pohimet gjatë takimit me studentët.</p> <p>Neni 76 i rregullores së UV përcakton se “studenti i vitit të parë që kalon në vitin e dytë duhet të ketë marrë të paktën 30 kredite”, ndërsa “për të kaluar në vitin e tretë duhet të ketë fituar të paktën 90 kredite”.</p> <p>[Evidenca C Rregullorja e UV, neni 76; Evidenca I.2 Rregullorja e Programi të ciklit të parë të studimit Bachelor në Ekonomiks]</p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Neni 6 i Rregullores së programit shprehet se “është e mundur njohja e plotë ose e pjesshme e studentëve që transferohen”. Për këtë ngrihet një Komision Ekuivalentimi, i cili duke zbatuar nenet 56, 57, 58, dhe 59 të Rregullores se UV vendos rast pas rasti.</p> <p>[Evidenca C Rregullorja e UV, nenet 56-59, Evidenca I.2 Rregullorja e Programi të ciklit të parë të studimit Bachelor në Ekonomiks, neni 6, Evidenca II.7 Procedura e transferimit]</p>
Kriteri 3. Institucioni	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të

informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>studentëve janë të përcaktuar në rregullore, kreu III, neni 8. Po ashtu në syllabusin e çdo lënde qëu bëhet i ditur studentëve që orën e parë të mësimit, ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit të tyre në çdo lëndë.</p> <p><i>Nga takimi me studentët u pohua se ata marrin dijëni të syllabusit të lëndës, por nuk e marrin atë të printuar apo në formë elektronike nëpërmjet sistemit UVMS ose e-mail-it.</i></p> <p>[Evidenca I.2 Rregullorja e Programi të ciklit të parë të studimit Bachelor në Ekonomiks, Kreu III, neni 8]</p>			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e UV dhe në rregulloren e programit përkatës të studimit.</p> <p><i>Të dhëna për diplomimin gjenden edhe në webfaqen e UV. Për të mbështetur edhe më tej studentët, sugjerohet të përgatitet një udhëzim specifik mbi procesin e punimit të Diplomës.</i></p> <p>[Evidenca C Rregullorja e UV, Evidenca I.2 Rregullorja e Programi të ciklit të parë të studimit Bachelor në Ekonomiks]</p>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Në fillim të çdo viti akademik UV organizon takime të hapura me të interesuarit për t'i informuar mbi programet e studimit që ofron. Po ashtu informacioni përcillet nëpërmjet ditës së orientimit, open days, panairëve të punës, udhëzuesve dhe fletëpalosjeve të ofruara prej tij. [Evidenca V.4-Aktivitete open day]</p> <p><i>Sugjerohet një plan më i detajuar në lidhje me promovimin e programit Bachelor në "Ekonomiks".</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Standardi V.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Studentët që pranohen në program informohen gjatë ditëve të orientimit kryesisht nga përgjegjësi i Departamentit, siç është

	<p>konfirmuar edhe nga takimi që GVJ pati me studentët. Gjithashtu informacion mbi organigramën e Fakultetit, dhe strukturën e programit të studimit afishohet në webfaqen e UV. Përveç kësaj Departamenti i Ekonomiksit ka përcaktuar edhe një kordinator programi, i cili ka si rol udhëzimin e studentëve në çdo kohë dhe plotësimkin e kërkesave që ata kanë. UV ka edhe një Njësi të shërbimit me studentin, e cila menaxhon dhe dërgon informacione të ndryshme nëpërmjet platformës së komunikimit, si p.sh. informacion për bursa, për karrierën, përjashtimet nga tarifa për kategori të caktuara (studentët në nevojë). Nëpërmjet kësaj zyre u krye dhe krijimi i Këshillave Studentore. GVJ konfirmoi sa më sipër gjatë takimit me Zyrën përkatëse dhe me studentët.</p> <p>[Evidenca II.3 Kordinatorët e programeve, takim me Zyrën e Këshillimit të studentëve]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që studentët që ditën e parë njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit dhe në orën e parë të mësimi u bëhet i njohur programi i lëndës. Nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit studentët marrin çdo informacion të nevojshëm në lidhje me lëndët, rregjistrimet, orarin dhe notat. Në faqen e internetit të UV publikohet orari mësimor dhe i provimeve, rregullorja e UV, dhe informacione të tjera shtesë për studentët. GVJ nga konstatimi i sistemit të menaxhimit konfirmoi se informacioni i përcillej online studentëve, por edhe nga takimi me studentët erdhi i njëjti pohim, <i>përveç në rastin e përcjelljes së syllabusit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi që GVJ pati me Zyrën e Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit konfirmoi se është një zyrë e re e krijuar e cila akoma nuk ka mundur të japë rezultate të punës së saj. <i>Mungesa e praktikës profesionale si kërkesë e detyrueshme e programit Bachelor në “Ekonomiks” nuk e lehtëson qasjen e studentëve me tregun e punës. Në këtë pikëpamje, institucioni akoma nuk mund të ofrojë informacion mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen e studentëve në tregun e punës. Po ashtu nuk janë arritur marrëveshje me aktorë lokalë për të ofruar një mbështetje të tillë. Sugjerojmë që Zyra e Këshillimit dhe Alumni-t të intensifikojë përpjekjet e saj për të krijuar rrjetizimin e nevojshëm me aktorët lokalë në përmbushje të këtij kriteri.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambjentet e Fakultetit dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. Po ashtu ky informacion disponohet edhe nëpërmjet UVMS, siç është konfirmuar nga sekretaria, Departamenti dhe studentët gjatë</p>

	takimeve që GVJ pati me ta.			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Çdo pedagog ofron komunikimin nëpërmjet UVMS dhe e-mail-it me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorët e teknologjisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	GVJ vizitoi Sekretarinë mësimore ku mbahen të tre regjistrat në lidhje me rregjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për vitin akademik 2019-2020 është 28 studentë ose rreth 33% më i lartë se në vitin akademik 2018-2019, por rreth 67% më i ulët se në vitin akademik 2016-2017. Sipas drejtuesve të njësisë bazë dhe njësisë kryesore në këtë trend ka ndikuar rritja e kufirit për mesataren në hyrje të studentëve në arsimin e lartë. Numri i të diplomuarëve në këtë program studimi në 3 vitet e fundit ka qënë 167 studentë, nga të cilët 52 në vitin akademik 2018-2019. GVJ kontrolloi regjistrin themeltar të studentëve të regjistruar dhe të transferuar si dhe regjistrin e arritjeve akademike me lëndë të zgjedhura rastësisht dhe nuk vërejti gabime apo problematika.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sipas legjislacionit në fuqi dhe Statutit të UV, institucioni disponon statistika për numrin e tërregjistruarve, tërheqjeve nga programi, largimeve etj. Numri i studentëve të regjistruar në PS për 3 vitet e fundit akademike është 84 nga të cilët vetëm 2 janë studentë të transferuar. Numri i të regjistruarëve në të tre vitet është pothuajse i njëjtë me numrin e studentëve të regjistruar në vitin akademik 2016-2017. Këto të dhëna janë në formë të shkruar dhe ruhen në Sekretarinë e Fakultetit në mënyrë konfidenciale. Për t'i paraprirë kësaj situatë UV ka realizuar një studim në vitin 2017 ku janë parashikuar rëniet në numrin e studentëve dhe faktorët që ndikojnë. Rënia e numrit të regjistrime është dukuri për të gjithë institucionin dhe sipas bisedës me

	drejtuesit e njësisë bazë dhe njësisë kryesore ata po punojnë për të adresuar këtë dukuri. [RVB, tab.21; Evidenca Infoarmacion për GVJ; Shënimet]			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore rezulton se sekretaria rregjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Informacioni hidhet online dhe është i aksesueshëm edhe nga studentët nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Sekretaria mësimore nëpërmjet sistemit elektronik që disponon mund të printojë listën e notave për studentët e vet.			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Detyrat e sekretarisë janë të përcaktuara në rregulloren e sekretarisë mësimore. GVJ ka bërë konstatime të të dhënave të studentëve të rregjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk ka vërejtur asnjë mangësi.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në fund të çdo viti akademik, institucioni bën një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të studentëve të cilin e përfshin në Raportin Vjetor të Departamentit të Ekonomiksit. Sipas Raportit vjetor për vitin akademik 2018-2019, cilësia e studentëve në hyrje konsiderohet e ulët me një kalueshmëri që varion nga 3,85% minimum në 91% për dhjetë lëndët e para. Ndërsa për studentët në dalje kalueshmëria është mbi 70%. <i>Për sa i përket punësimit të studentëve institucioni edhe pse i ka krijuar strukturat, ende nuk ka mundur të marrë apo të rrisë shkallën e punësimit të tyre.</i> <i>Sugjerohet të merren masa për rritjen e cilësisë në hyrje të studentëve, dhe të përmirësimit të funksionit të Zyrës përkatëse të Këshillimit dhe Alumni.</i> [Evidenca Raporti Vjetor i Departamentit të Ekonomiksit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Statuti dhe Rregullorja e UV parashikon përfshirjen e studentëve në hallkat vendimmarrëse dhe këshilluese. Gjatë 2019 janë kryer zgjedhjet studentore për Këshillin studentor dhe përfaqësuesit e tyre në organet drejtuese të UV. Përfaqësues të studentëve janë në Bordin e Administrimit dhe në Senatin Akademik.</p> <p>[Evidenca A Statuti UV]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Studentëve është angazhuar maksimalisht në orientimin e studentëve në lidhje me të drejtat e tyre dhe përfaqësimin e tyre në hallkat e institucionit, për të sjellë shqetësimet dhe zgjidhjet e tyre. <i>Gjatë vizitës GVJ konfirmoi se ekzistonte një lloj hezitimi nga ana e studentëve për të qenë pjesë e këtyre hallkave pasi edhe Këshilli Studentor u krijua pas shumë përpjekjesh. Në këtë aspekt institucioni duhet të punojë më shumë me fushata informacioni dhe krijimin e bërthamës së parë që të lejojë vazhdimësinë tek brezat në vijim.</i></p> <p>Nevojitet të theksohet gjithsesi se studentët janë të përfshirë në vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet pyetësorëve që plotësojnë; proces i cili kryhet në mënyrë të pavarur nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>[Evidenca III.1 Procedura e analizës së pyetësorëve]</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se programet e studimit janë hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve dhe duke zbatuar ligjet në fuqi. Statuti i UV dhe rregulloret përkatëse parashikojnë procedurë joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme, mobilitetet e studentëve dhe ripranimin në programin e studimit.</p> <p>[Evidenca I.5 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Ekonomiks]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimmarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Si një mënyrë e drejtpërdrejtë në këtë drejtim shërben edhe pyetësori që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri. Ky pyetësor menaxhohet në mënyrë të pavarur nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe analiza e rezultateve i shkon Rektorit, i cili duke e përcjellë në Departament, urdhëron të përpilohet plani i masave përkatëse. GVJ konstatoi këtë proces nëpërmjet dokumentacionit të disponuar dhe takimit me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që analiza që i përket stafit akademik të</i></p>

	<i>Departamentit të Ekonomiksit të përfshihet në raportin vjetor të tij, së bashku edhe me planin e masave (nëse ka).</i> [Evidencat K dhe L Raporti mbi analizat e pyetësorit studentor përi vitet akademike 2017-2018 dhe 2018-2019, Takimi me NJSBC]			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Rregullorja e Departamentit (neni 21 pikat b, i, j, k) dhe rregullorja e programit të studimit (nenet 8,9,10, 11, 12) mundësojnë barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit studentëve si dhe nëpërmjet përcaktimit të procedurës që ndiqen nga institucioni në këtë rast. GVJ konstatoi se ky informacion ju behej me dije studentëve edhe nga Sekretaria Mësimore dhe u konfirmua po ashtu edhe nga takimi me studentët, të cilët referuar se kjo e drejtë e tyre ishte plotësuar në rast nevojë. [Evidenca I.2 Rregullorja e Departamentit të Ekonomiksit; Evidenca I.5 Rregullore e programit të studimit Bachelor ne Ekonomiks, Evidenca Shënimet]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	UV në strukturën e vet ka ngritur Drejtorinë e Edukimit që përfshin Sektorin e Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentit dhe Sektorin e Këshillimit të Karrierës. Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Kjo Drejtori ka krijuar edhe rregulloren e vet siç është konfirmuar gjatë vizitës nga GVJ. [Evidenca A Statuti, neni 77, Evidenca C Rregullore UV, neni 85]
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe	UV ka krijuar strukturat e posaçme dhe funksionale në shërbim të studentëve, duke ju referuar këtu Sekretarisë mësimore, Kordinatorit të programit, Sektorin e Kurrikulës dhe Shërbimit ndaj Studentit dhe Sektorin e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Rregulloret e institucionit parashikojnë pjesëmarrjen e studentëve në organet vendimarrëse, këshilluese dhe të kontrollit të cilësisë

<p>programin e studimit.</p>	<p>së mësimdhënies në mënyrë që ata asistojnë në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p>Drejtoritë në shërbim të studentit të përmendura më sipër janë krijuar dy vitet e fundit, por vlen të theksohet puna e tyre në lidhje me mbështetjen e studentëve. Aktivitete të tilla si ditët e informacionit, panairi i punës, dhe fushatat e informimit të krijuara nga studentë dhe pedagogë për të promovuar shërbimet e tyre dhe programin e studimit janë disa nga funksionet që këto Sektorë përmbushin në të gjithë sistemin e mbështetjes së studentit.</p> <p><i>Sugjerohet që kjo Drejtori të përforcohet dhe mbështetet edhe më shumë nga institucioni për të kryer të gjitha funksionet e nevojshme në shërbim të studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, pjesë e Drejtorisë së Edukimit, ka filluar aktivitetin e tij rishtaz duke ofruar shërbime të ndryshme këshillimi dhe konsultimi për studentët e rinj dhe për ata që diplomohen. Roli i tyre konsiston në informimin e studentëve lidhur me procesin mësimor, mundësi për pjesëmarrje në konferenca studentore, dhe mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore si dhe realizimin e praktikave profesionale pranë insitucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe takimi me përfaqësues të Sektorit u konstatua nga GVJ se vështirësia me e madhe për këtë Sektor është krijimi i partneriteteve të tilla që t'u mundësojnë studentëve një praktikë apo një punësim në mbarim të studimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, pjesë e organigramës së institucionit ka si detyrë edhe gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ky proces ka filluar të kryhet nga Sektori duke dërguar një formular në instucione të ndryshme për të marrë të dhëna për studentët, proces i cili nuk ka patur rezultate të larta. Drejtoria ka bërë në Rektorat një kërkesë për të gjurmuar nga rrjetet e ndryshme sociale, është në proces për të ndërtuar faqen web dhe për të krijuar shoqatën Alumni , si dhe për të zhvilluar takime me alumni dhe histori sukseesi nga student të diplomuar.</p> <p><i>Sektorët e kësaj Drejtorie nuk kanë prodhuar akoma një Raporti Vjetor të konsoliduar të aktiviteteve të tyre; ato prodhojnë një relacion. GVJ sugjeron që ky Sektor të përqëndrohet në krijimin e bërthamës së shoqatës, në plotësimin e faqes web, në grumbullimin e adresave personale të studentëve në pranim në mënyrë që të gjurmohen pas diplomimit, në krijimin e infrastruktures së nevojshme të gjurmimit si psh nëpërmjet</i></p>

	<i>rrjeteve sociale, dhe në krijimin e një raporti të përvitshëm për të gjitha aktivitetet studentore, sportive dhe kulturore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UV në përmbushje të kërkesave të ligjit dhe të misionit të vet strategjik ka krijuar struktura dhe ka hartuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë në mësimdhënie. Këtë e ka paraqitur në Statut, kreu VIII neni 81-83 për krijimin e strukturave, dhe neni 22 për ngritjen e Komisioneve të Përhershme të Sigurimit të Cilësisë në nivel institucional dhe të Fakultetit. Gjithashtu në rregulloren e UV neni 84 parashikohen politikat e përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie, si dhe me vendim Senati nr. 21 janë përcaktuar të gjitha procedurat dhe mekanizmat e arritjes së nivelit të dëshiruar të cilësisë për programin. UV ka parashikuar në organigramën e tij Njësinë e Sigurimit të Cilësisë, të Projekteve dhe marëdhënieve me jashtë, e cila është funksionale dhe konform ligjeve. [Evidenca A Statuti, Evidenca C Rregullorja UV, Evidenca III.1 Vendimi i Senatit nr. 21/08-05-2018 Procedura e analizës së pyetësorëve, Evidenca III.2 Vendimi Senatit nr 54 Per krijimin dhe funksionimin e komisioneve te përhershme, takim me NJSBC]
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe	Sistemi operativ i sigurimit të cilësisë përfshin Njësitë, Komisionet, rregulloret, procedurat, udhëzimet dhe instrumentat e sigurimit të cilësisë. Në bazë të statutit dhe rregullores së institucionit siç është përmendur më sipër, institucioni e ka ngritur sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, i cili monitorohet nëpërmjet Njësisë së Brendshme të Sigurimit të

<p>studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Cilësisë dhe Komisioneve të Përheshme në nivel Institucioni dhe Fakulteti. Në NJSBC përfshihet personel administrativ i cili ndjek procedurat për sigurimin e cilësisë dhe ka karakter kryesisht administrativ dhe procedural. Roli i Njësisë përfshin zbatimin e procedurës së pyetësorëve të studentëve, i cili është instrumenti kryesor për sigurimin e cilësisë. Njësia varet nga Rektori dhe është akoma në proces përpilimi i rregullores së saj të brendshme, siç u përmend në takimin me përfaqësues të saj. Ndërsa Komisionet e Përhershme të ngritura në nivel Institucional dhe Fakulteti përfshijnë staf akademik (6 persona) dhe një student, duke siguruar kështu përfshirjen e studentëve në procesin e sigurimit të cilësisë. <i>Por në këto Komisione nuk parashikohet përfshirja e bashkëpunëtorëve apo e ekspertëve të jashtëm.</i> Roli i Komisioneve të Përhershme përfshin garantimin e standarteve të cilësisë në nivel akademik dhe administrativ. Më konkretisht ato sigurojnë cilësinë në procesin mësimor të programit të studimit, në rezultatet akademike të studentëve dhe në marrëdhëniet e tyre me stafin akademik. <i>Gjithsesi duhet shënuar se edhe pas vizitës së kryer me stafin e NJSBC është konfirmuar se Komisionet e Përhershme akoma nuk janë aktive.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se sistemi i sigurimit të cilësisë është i ngritur, por jo akoma në funksion të plotë.</i></p> <p>[Evidenca III.2 Vendimi Senatit nr 54 Per krijimin dhe funksionimin e komisioneve te përhershme, Takimi me NJSBC]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Instrumentat kryesorë që përdor institucioni për vlerësimin e brendshëm janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pyetësori i studentëve për vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie; 2. Pyetësori i studentëve për vlerësimin e shërbimeve administrative. <p>Në vijim të takimit që GVJ kishte me NJSBC u informua për procesin e zhvillimit të pyetësorëve i cili kryhet igjithi në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit që UV disponon. Studentët informohen nëpërmjet sistemit elektronik për të kryer pyetësin për vlerësimin e cilësisë. Të gjitha përgjigjet e tyre në formë anonime mbledhen në një database elektronike; në vijim NJSBC kryen përpunimin e të dhënave, dhe prodhon një raport që dërgohet në Rektorat dhe në Departamentet përkatëse me sugjerime. Pyetësori përfshin 16 pyetje nga të cilat 14 të mbyllura dhe 2 të hapura. Në procesin e fundit siç u përmend nga NJSBC u krye përpunimi i të dhënave për 12850 pyetësorë, që tregojnë se përfshirja e studentëve në proces ka qenë e madhe. Në vijim Departamenti harton planin e masave i cili percillet në hallkat</p>

	<p>administrative dhe i dërgohet në fund Rektorit.</p> <p><i>Nga rishikimi dhe krahasimii dy raporteve të viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 në lidhje me përfundimet e tyre, GVJnuk vëren ndyshime të mëdha për sa i përket konkluzioneve të nxjerra nga analiza, veçanërisht për pikat e dobëta që lidhen me: vështirësitë e lëndëve, mosinkurajimi i mendimit kritik dhe diskutimit në klasë, mungesës së infrastukturës në auditorë, laboratorëve didaktikë dhe praktikave lidhur me programin. Po ashtu plani i masave i marrë nga Departamenti në lidhje me raportin e NJSBC është kryer shumë vonë në kohë për vitin akademik 2018-2019</i>[Evidenca III.5 Kthim përgjigje për raportin e analizës së pyetësorëve]</p> <p><i>Në funksion të sigurimit të cilësisë GVJ sugjeron të merren masa konkrete për çdo pikë të raportit të NJSBC nga Njësitë kryesore me qëllim sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe ky plan masash të hartohen në kohë në fillim të vitit akademike të monitorohet nga NJSBC në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike.</i></p> <p>Programi Bachelor ne “Ekonomiks” po kalon akreditimin e tij të parë, pas akreditimin institucional të UV në 2017-ën. Për akreditimin institucional UV ka ndërmarrë një plan masash i cili është dorëzuar pranë ASCAL.</p> <p>[Evidencat K dhe L Raport mbi rezultatin e pyetësorit studento për vitin akademik 2017- 2018 dhe 2018 - 2019,Evidenca III.5 Kthim përgjigje për raportin e analizës së pyetësorëve]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kultures së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Instrumentat e përmendur më sipër përdoren në mënyrë periodike nga institucioni për vlerësimin e brendshëm. Këto instrumenta janë relativisht të rinj në përdorim të institucionit dhe nuk përfshihen në raportin vjetor të Departamentit. Po ashtu, NJSBC harton raport të analizës së pyetësorëve, por jo një raport vjetor të aktivitetit të saj. Shembujt konkret që këto mekanizma funksionojnë janë të vërtetueshëm nëpërmjet dokumentacionit dhe takimeve që GVJ pati me palët e përfshira në proces, <i>por rezultatet e analizave akoma nuk janë marrë në konsideratë për plotësim me masa konkrete për të krijuar një diferencë midis viteve akademike. GVJ konstatoi të njëjtat shqetësime të studentëve nga një vit në tjetrin. Konstatuar edhe takimi me NJSBCVI vërehet një lloj mosbesimi në proces dhe pranimi i kulturës së sigurimit të cilësisë, jo vetëm nga pedagogët por edhe nga studentët. Përdorimi i studentëve në fazat e pilotimit ka ndihmuar, por gjithsesi ngelet një sfidë krijimi i kulturës institucionale.</i></p> <p><i>Gjithsesi GVJ gjykon se të gjitha përpjekjet e institucionit</i></p>

	<i>bashkohen në atë që mund të quhet krijimi i kulturës së cilësisë në rang institucional. Por nevojitet akoma shumë punë dhe përpjekje për përdorimin e duhur të mekanizmave të sigurimit të cilësisë në të gjitha hallkat që përfshijnë edhe rekrutimin e stafit, organizimin e programit mësimor, rishikimet e programit studimor, zhvillimin e programit dhe kërkimin. NJSBC në çdo rast duhet të jetë prezent për të siguruar cilësinë dhe për të krijuar një kulturë në rang institucional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të pare.	Bazuar në rregulloren e Departamentit, Njësia bazë për menaxhimin e programit të studimit është Departamenti i Ekonomiksit, por UV ka ngritur edhe strukturën e Drejtorisë së Edukimit, Sektorin e Kurikulës dhe Shërbimit ndaj Studentit. Këto njësi së bashku me NJSBC dhe Komisionet e Përhershme të Sigurimit të Cilësisë, kryejnë mbikëqyrjen, rishikimin dhe monitorimin e programeve dhe kanë si qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes ushtrimit të funksioneve të tyre.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të pare.	Departamenti i Ekonomiksit, si njësi bazë e menaxhimit të programit të studimit propozon ndryshimet në kurikulën e programit. Këto ndryshime përcillen në vijin nga Dekanati në Rektorat dhe Senat për vendimarrje. Rishikimet e programit të studimit janë kryer në bazë të kërkesave ligjore kryesisht, por edhe duke vërejtur nevoja të ndryshme për shtimin apo heqjen e lëndëve. Sipas Evidencës I.9 për rishikimin e programeve studimore të kryer në vitin 2017, për programin në fjalë janë kryer përshtatjet sipas ligjit, janë përfshirë disiplina të reja, janë riorganizuar disa disiplina, riemërtuar disa të tjera dhe është ndryshuar ngarkesa mësimore në disa të tjera. Të gjitha ndryshimet janë në masën nën 20% dhe janë përcjellë me procedurë të veçantë në Rektorat dhe Senat. Pas miratimit të tyre janë dërguar në autoritetet përkatëse (Ministri) për dijeni nga ku është marrë edhe kthim përgjigje për ndryshimet. Të gjitha hallkat e ndjekura në këtë proces siç është vënë në dijeni GVJ janë të dokumentuara dhe formalizuara.

<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>[Evidenca I.9 Rishikim Plani dhe Përmirësim Kurrikule]</p> <p>Për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve institucioni monitoron periodikisht nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pyetësi i studentëve për vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie; 2. Pyetësi i studentëve për vlerësimin e shërbimeve administrative. <p>NJSBC harton raporte vjetore për analizën e pyetësorëve me gjetjet kryesore dhe sugjerime për plan masash. Në vijim Senati ngarkon me vendim të posaçem planin e masave për përmirësimin e programeve.</p> <p>Me urdhër të Rektorit nr 123/dt. 19/12/2019 është ngritur një grup pune për përmirësimin e pyetësorit të studentëve i përbërë nga Dekanët dhe staf akademik dhe i ngarkuar për të përmirësuar pyetësorin dhe për të hartuar një raport përmbledhës për Senatën Akademik.</p> <p>Po ashtu nevojitet të theksohet se Sektori i Kurrikulës dhe Shërbimit të Studentit ka kryer një studim në lidhje me faktorët kryesorë që ndikojnë në ecurinë e programeve, për të patur një kornizë më të gjerë të arsyeve kryesore të disa programeve të pafrekuentuara. Ky Sektor po ashtu ka ndërmarë dhe koordinuar procesin e rishikimit të literaturës për të respektuar afatet ligjore, rishikimin e syllabuseve të programit të studimit për të respektuar ndryshimet sipas ligjit dhe ka krjuar dosjet për secilin program.</p> <p>GVJ konstaton se të gjitha Njësitë që kanë në ngarkim monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së programit dhe përdorimin e instrumentave të ndryshëm, funksionojnë në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra, por vërehet një mungesë koordinimi i punës dhe kryesisht i rezultateve të tyre. Mendojmë se duhet një koordinim më i mirë për sa i përket hallkave të sigurimit të cilësisë me detyra të mirëpërcaktuara dhe procese komunikimi dhe monitorimi të qarta midis Departamentit, NJSBC dhe Sektorit të Kurikulës për të siguruar rritjen e cilësisë së programit. Natyrisht fakti që të gjitha strukturat janë relativisht të reja krijon një lloj konfuzimi fillimisht, i cili në vijim duke përdorur procedurat e duhura mund të minimizohet dhe të funksionojë në mënyrën e duhur.</p> <p>[Evidencat K dhe L Raport mbi rezultatin e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017- 2018 dhe 2018 - 2019;Evidenca VI.1 Urdhër nr. 123 dt19/12/2019; Evidenca VI.2 Vendim Senati nr.17/dt. 28/03/2019 për Planin e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programe të studimit dhe mësimdhënies në UV, Takim me NJSBC dhe DKSHS]</p>
---	---

<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Për sa i përket rezultateve të instrumentave vlerësues e monitorues ato i bëhen të njohura Rektoratit dhe Departamenteve, të cilat duhet të hartojnë planin e masave konkrete.</p> <p>[Evidencat K dhe L Raport mbi rezultatin e pyetësorit studento per vitin akademik 2017- 2018 dhe 2018 -2019; Evidenca III.5 Kthim përgjigje për raportin e analizes së pyetësorëve]</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Raportet e krijuara nga NJSBC përfshijnë rezultatet e pyetësorve dhe analizën sasiore dhe cilësore të tyre në rang institucional dhe në rang Fakulteti/programi. Po ashtu propozohet një plan masash për të gjitha Fakultetet. Departamenti si njësi bazë nëpërmjet kthimit të përgjigjes për analizën e pyetësorëve përfshin rishikim të rezultateve, përcaktim të problematikave të veçanta, sugjerime për zgjidhjen e tyre.</p> <p><i>GVJ sugjeron se rezultatet e vlerësimit duhet të jenë pjesë e Raportit vjetor të Departamentit.</i></p> <p>[Evidencat K dhe L Raport mbi rezultatin e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017- 2018 dhe 2018 -2019; Evidenca III.5 Kthim përgjigje për raportin e analizes së pyetësorëve; Evidenca II.14 Raporti vjetor i Departamentit të Ekonomiksit]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.3</p> <p>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit, i cili është përgjegjës për programin e studimit nën shqyrtim, ka kryer një vlerësim të brendshëm për këtë program studimi nëpërmjet këtij raporti të vetëvlerësimit, i cili është i pari për programin dhe vjen pas raportit të akreditimit institucional të vitit 2017.</p> <p>Rezultatet e vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të jashtëm pritët të përfshihen në raportin e masave dhe planit për zbatim e plotësim të vitit akademik në vijim.</p> <p>Gjithashtu, Departamenti realizon në mënyrë periodike analizë të punës mësimore dhe shkencore të stafit akademik që mbulon programin e studimit. <i>Në këtë raport nuk përfshihet analiza e cilësisë së programit të studimit.</i></p>

	<p>[Evidenca II.14 Raporti vjetor i Departamentit të Ekonomiksit]</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit të brendshëm institucioni ka përdorur praktikatat e vetvlerësimit siç ato kërkohen nga ASCAL. Ky proces vetvlerësimi siç përmendet edhe nga RVB ka qenë një burim i rëndësishëm informacioni për të mirëpërcaktuar rolet e secilës Njësi, mënyrën e përdorimit të instrumentave të nevojshëm dhe specifikë me natyrën e programit. Në këtë kontekst institucioni përdor RVB dhe instrumentat e sigurimit të cilësisë (pyetësorët) për të kryer vetvlerësimin e për programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të cilësisë së programit, përveç analizës së pyetësorëve, raporteve të vetvlerësimit dhe analizave të NJSBC, Departamenti përdor edhe vlerësimin e performances së stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Në këtë format vlerësimi përfshihen mësimdhënja (syllabusi, zhvillimi i leksioneve/seminareve, respektimi i orarit), fusha kërkimore dhe mbështetja administrative e pedagogut. Ky formular plotësohet nga përgjegjësi i Departamenti dhe firmoset nga ai dhe i vlerësuari. Analiza përmbledhëse e aktivitetit mësimor dhe shkencor përfshihet në Raportin Vjetor të Departamentit.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik Departamenti diskuton dhe miraton literaturën e përdorur për lëndët, si dhe kontrollojnë syllabuset dhe përmbajtjen e tyre për t'u siguruar që kanë përfshirë sugjerimet e një viti të kaluar e për të përfshirë ndryshime të reja të mundshme.</p> <p><i>Edhe pse në RBV përmendet se përgjegjësi i Departamentit kryen vëzhgime në auditor, nuk ka një instrument të posaçëm që përdoret nga institucioni për ta dokumentuar këtë. GVJ sugjeron pasurimin e përdorimit të metodave të drejtpërdrejta për sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</i></p> <p>[Evidenca Vlerësimi i përfundimit të stafit akademik me kohë të plotë ose të pjesshme, Evidenca II.9 Miratimi dhe përcjellja e literaturës nga Departamenti i Ekonomiksit]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të</p>	<p>UV ka ngritur infrastrukturën e posaçme për të rrjetëzuar studentët Alumin, por akoma nuk janë arritur rezultate të dukshme të krijimit të bërthamës. Në këtë kontekst nevojitet më shumë përpjekje e organizuar në mënyrë që sondazhet në lidhje me këta studentë të përfshihen në vlerësimin e cilësisë së programit.</p> <p><i>GVJ gjykon nga konstatimet në vend dhe nga dokumentacionin se institucioni nuk përdor në masë metoda të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programit, realizimin dhe mbarëvajtjen e tij, siç janë intervistat apo sondazhet dhe se ka hapësira që institucioni të përmirësojë në këtë drejtim.</i></p>




studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Procedurat e brendshme të cilësisë përfshijnë NJSBC, Departamentin dhe Fakultetin në të gjitha hallkat e sigurimit të cilësisë. Në Komisionet e Përhershme parashikohet një anëtar nga studentët, <i>por në këto Komisione nuk parashikohet një anëtar i jashtëm i pavarur dhe këto Komisione ende nuk janë bërë aktive.</i> [Evidenca III.2 Vendimi Senatit nr 54 Për krijimin dhe funksionimin e komisioneve të përhershme, Takimi me NJSBC]
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Dokumentacion kryesor institucional; Statuti, Rregullorja UV dhe Procedurat e analizës dhe vlerësimit të pyetësoreve përcaktojnë detyrat konkrete të palëve të përfshira në procesin e sigurimit të cilësisë. NJSBC është në proces të miratimit të rregullores së vet të brendshme. <i>GVJ gjykon se në këtë aspekt ka vend për përmirësim në komunikim procedural më të mirë midis Fakultetit, Departamentit, NJSBC dhe Sektorit të Kurrikulës dhe Shërbimit ndaj studentit.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Ekonomiks” janë përfshirë Fakulteti, Departamenti, NJSBC dhe studentët nëpërmjet pyetësorit. [Evidencat K dhe L Raport mbi rezultatin e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017- 2018 dhe 2018 -2019; Evidenca III.5 Kthim përgjigje për raportin e analizes së pyetësorëve, Evidenca II.14 Raporti vjetor i Departamentit të Ekonomiksit]
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion vërehet se aktorët e përfshirë në proces në mënyrë të pavarur janë përfshirë duke

<p>brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>dhënë mendimin e tyre dhe duke mos lënë hapësirë për identifikimin e ndonjë diskriminimi apo pabarazie gjatë procesit. Kjo u konstatua edhe nga takimet me të gjithë aktoret: studentë, NJSBC, Departament.</p> <p>[Evidencat K dhe L Raport mbi rezultatin e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017- 2018 dhe 2018 -2019; Evidenca III.5 Kthim përgjigje për raportin e analizes së pyetësorëve; Evidenca II.14 Raporti vjetor i Departamentit të Ekonomiksit]</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p><i>Në Komisionet e përheshme të sigurimit të cilësisë nuk përfshihet një anëtar/ekspert i jashtëm.</i> Gjithsesi duke ju referuar RVB dhe dokumentacionit, institucioni ka mundur të bëjë pjesë të proceseve të vlerësimit aktorë të jashtëm nëpërmjet workshopeve të organizuara.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.5</p> <p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>I gjithë procesi i lidhur me sigurimin e cilësisë dhe me instrumentin kryesor që kalidhje me pyetësorët dhe analizën e tyre, si një prej mekanizmave më të rëndësishëm të sigurimit të cilësisë, behet i njohur tek hallkat administrative Senat, Rektorat, Fakultet, Departament, NJSBC.</p> <p><i>Po ashtu sipas RVB, raporti disponohet nëweb, por GVJ nuk ka mundur ta konstatoje nëwebfaqe.</i></p> <p>[Evidencat K dhe L Raport mbi rezultatin e pyetësorit studentor për vitin akademik 2017- 2018 dhe 2018 - 2019,Evidenca III.5 Kthim përgjigje për raportin e analizes së pyetësorëve; Evidenca II.14 Raporti vjetor i Departamentit të Ekonomiksit]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e</p>	<p>Programi në fjalë është gjatë akreditimi të tij të parë për sa i përket sigurimit të cilësisë. Institucioni ka kaluar një vlerësim</p>

<p>vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>institucional, të cilin e ka publikuar në webfaqen e tij, duke respektuar ligjet në fuqi dhe lirinë akademike.</p> <p>Edhe pse në RVB shprehet se rezultatet e raportit të pyetësorëve janë publike, <i>GVJ nuk ka mundur t'i konstatojë nëpërmjet webfaqes.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të pyetësorëve janë shoqëruar me një plan masash, për të cilat GVJ gjykon se janë marr vonë në konsideratë.</p> <p>[Evidencat K dhe L Raport mbi rezultatin e pyetësorit studento për vitin akademik 2017- 2018 dhe 2018 - 2019; Evidenca III.5 Kthim përgjigje për raportin e analizës së pyetësorëve; Evidenca II.14 Raporti vjetor i Departamentit të Ekonomiksit]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të sigurimit të cilësisë dhe të efektivitetin të veprimtarive institucioni ka ngritur Komision për planin e masave për përmirësimin e vazhdueshëm. Frytet e tij do të shfaqen në vijim, GVJ nuk mund të shprehet për momentin saktësisht në lidhje me arritjet e planit.</p> <p>[Evidencat K dhe L Raport mbi rezultatin e pyetësorit studento për vitin akademik 2017- 2018 dhe 2018 -2019; Evidenca VI.1 Urdhër nr. 123 dt19/12/2019; Evidenca VI.2 Vendim Senati nr.17/dt. 28/03/2019 për Planin e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programe të studimit dhe mësimdhënies në UV, Takim me NJSBCVI dhe DKSHS]</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Ndër veprimtaritë kryesore që institucioni ka ndërmarë në lidhje me ndërgjegjësimin dhe informimin e studentëve dhe personelit kanë qenë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përfshirja e stafit në trajnimet e Ascal 2. Përfshirja e studentëve në pilotimin e pyetësorëve 3. Përfshirja e stafit akademik në fushatat e informimit të studentëve të sapoardhur. <p>[Evidenca Takimi me NJSBCVI, Studentët]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Ekonomiks” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Struktura ndihmës akademike të ngritura dhe funksionale në shërbim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, shërbime dhe informimit të studentëve.
2. Institucioni ofron një infrastrukturë të plotë dhe cilësore për zhvillimin normal të programit të studimit.
3. Personeli akademik që mbulon mësimdhënien në këtë program studimi është i kualifikuar, me eksperiencë dhe i përkushtuar në realizimin e objektivave të programit të studimit.
4. Kurrikula e programit është bashkëkohore, në përputhje me objektivat e programit të studimit, dhe i përgjigjet kërkesave të tregut të punës.
5. Mbulimi i mësimdhënies realizohet kryesisht nga personeli me kohë të plotë i FEUV.
6. Institucioni disponon një platformë online (UVMS), e cila është funksionale dhe mundëson menaxhimin e informacionit për personelin akademik, studentët dhe stafin.
7. Eksperiencë e mirë e personelit akademik të programit të studimit në veprimtarinë kërkimore shkencore.

Pika të dobta:

1. Mungesa e një studimi mbi nevojat e tregut të punës për studentët që përfundojnë këtë program studimi.
2. Numër më i vogël studentësh të regjistruar se sa kuotat e miratuara në tre vitet e fundit akademike.
3. Përfshirje e ulët e studentëve në projekte dhe veprimtari kërkimore.
4. Përfshirje e ulët e studentëve në programet Erasmus+.
5. Mungesa e praktikës profesionale në planin mësimor.
6. Numri i vogël i kopjeve në bibliotekë për tekstet e rekomanduara si literaturë e detyruar.
7. Sistemi i sigurimit të cilësisë është i ngritur, por akoma nuk është në funksion të plotë.
8. Mungesa e një anëtari/eksperti të jashtëm në komisionin e sigurimit të cilësisë.

9. NJSBCVI nuk përdor në masë metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programit.
10. Njësitë që kanë në ngarkim monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së programit dhe përdorimin e instrumentave të ndryshëm, funksionojnë në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra, por vërehet një mungesë koordinimi e punës dhe kryesisht i rezultateve të tyre.
11. Institucioni nuk ka një plan të detajuar për trajnimin e vazhduar për stafin dhe studentet e diplomuar.

Rekomandime:

1. Institucioni të realizojë një studim për të identifikuar nevojat e tregut të punës për studentët që diplomohen në këtë program studimi.
2. Njësia bazë duhet të analizojë shkaqet e rënies së numrit e studentëve të regjistruar, duke e parë këtë edhe nga këndvështrimi i punëdhënësve si dhe të hartojë një plan më të detajuar në lidhje me promovimin e programit Bachelor në Ekonomiks.
3. Departamenti duhet të nxitë studentët për t'u përfshirë në projektet kërkimore të departamentit.
4. Të informohen dhe mbështeten studentët që në semestrin e parë për t'u bërë pjesë e programit të mobiliteteve.
5. Të përfshihet praktika profesionale në planin mësimor.
6. Të vazhdojë rritja e fondit të literaturës së detyrueshme kopje fizike në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, mbështetur në kërkesat e njësive bazë.
7. Strukturat e reja si Drejtoria e Edukimit, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të përforcohen dhe mbështeten edhe më shumë nga institucioni me burime për të kryer të gjitha funksionet e nevojshme në shërbim të studentëve dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.
8. Të shihet mundësia e përfshirjes së një anëtari/eksperti të jashtëm në komisionin e përhershëm të sigurimit të cilësisë.
9. NJSBCVI duhet të shoh mundësinë e përdorimit të metodave të drejtpërdrejta dhe metoda të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programit, realizimin dhe mbarëvajtjen e tij, siç janë intervistat apo sondazhet, vëzhgime në auditor, etj.
10. NJSBCVI dhe njësitë e tjera përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të kenë një koordinim të punës dhe rezultateve midis tyre si dhe duhet të ndjekin në vijimësi zbatimin e rekomandimeve nga Njësitë bazë dhe

zbatimi i tyre duhet të reflektohet në raportin e veprimtarisë së këtyre njësive (si pjesë e raportit vjetor).

11. Institucioni të hartojë një qasje më sistematike në fushën e trajnimit ku të përfshihen trajnimet për personelin akademik dhe ndihmës akademik, trajnime të vazhdueshme për studentët e diplomuar duke vënë në efikasitet të plotë Qendrën Studimore Ndërdisciplinore.
12. Institucioni të rishikojë strategjinë për trajnimin e vazhdueshëm të kërkuesve të rinj duke planifikuar aktivitete që mbështesin trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik.
13. Të merren masa për përmirësimin e funksionit të Zyrës përkatëse të Këshillimit dhe Alumni dhe të intensifikohen përpjekjet e saj për të krijuar rrjetizimin e nevojshëm me aktorët lokalë.



Conclusions of the evaluation of the first cycle study program, Bachelor in Economics of the University of Vlora “Ismail Qemali”

Strengths and Affirmations:

1. Supportive and functional academic structures created to increase the quality of teaching, services and information of students.
2. The institution offers a complete and qualitative infrastructure for the pursue of the study program
3. The academic personnel that supports this study program is qualified, experiences and dedicated to realize the study program’s objectives.
4. The curriculum of the study program is contemporary and in compliance with the study program’s objectives as well as with the market needs.
5. The teaching process is mainly covered from full time academic personnel of the Economic Faculty.
6. The institution has an electronic platform that is functional and enables the information management for the academic, administrative staff and students.
7. There is a good experience of the academic personnel of the study program in research activities.

Weaknesses:

1. A lack of a market study to address the market needs for the students that complete this study program.
2. A reduced number of students compared to the quotas approved for the last three academic years.
3. A low participation of students in projects and research activities.
4. A low participation of students in Erasmus+ programs.
5. The lack of internship in the curriculum.
6. A small number of copies in the library for recommended texts such as compulsory literature.
7. A quality assurance system is in place, but not yet fully functioning.
8. Lack of an external member / expert in the Quality Assurance Committee.
9. The Quality Assurance Unit does not extensively use direct and indirect methods to evaluate the quality of the study program.



10. There is a lack of coordination and results of the units that monitor the quality of the study program and the usage of different instruments, even though they work independently from each other.
11. The institution does not have a detailed plan for continuous training for staff and graduate students.

Reccomendations:

1. The institution should conduct a study to identify the needs of the labor market for students graduating from this study program.
2. The Department should analyze the reasons for the reduction of the number of students, based also from the market prospective as well as should define a detailed plan to promote the study program Bachelor in Economics.
3. The department should encourage students to get involved in the research projects of the department.
4. Freshman students should be informed and supported to be part of the mobility programs.
5. The institution should include the Internship in the curricula.
6. To continuously increase the fund for the mandatory literature in hard copies in Albanian and other foreign languages based on the requests of the Departments.
7. The new structures such as the Directory of Education, Directory of Quality Assurance should be reinforced and supported from the institution with the provision of all the required resources necessary for their activity to serve the students and to meliorate the quality of teaching.
8. An external expert should be included in the Quality Assurance Committee.
9. The Quality Assurance Unit should review the possibility of the usage of direct and indirect methods for the evaluation of the quality of the program, its realization and continuity such as interviews, questionnaires, class surveillances etc.
10. IQAU and other units responsible for monitoring and ensuring the quality of the study program should have a coordination of work and results between them and should continuously follow the implementation of the reccomendations from the Departments. The implementation timeline should be reflected in the annual report of the Department.



11. The Institution should strategically define a training agenda, where it should include the training of academic and administrative staff and the training of alumni so that the Centre of Interdisciplinary Research to be active and efficient.
12. The Institution should revise its strategy regarding the continuous training of young researchers and include activities and events that support the long life learning process of its academic staff.
13. Measures need to be taken to meliorate the Alumni and Carees Office activities and an intensification of its efforts to create the necessary network with local participants.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	